

BASHKIA LEZHË

**PLANI I MENAXHIMIT
TË INTEGRUAR TË MBETJEVE
2021 – 2025
BASHKIA LEZHË**

MARS 2021

Mirënjohje

Plani i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane 2021-2025, është hartuar nga Bashkia Lezhë me asistencë të veçantë nga “Bashki të Forta”, projekt i ambasadës Zvicerane në Shqipëri, i zbatuar nga Helvetas dhe me kontribut të vazhdueshëm nga Instituti i Kërkimeve Urbane – URI dhe EcoDes Studio.

Ky dokument është hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Lezhë Z. Pjerin NDREU, i cili jo vetëm që e ka ndjekur të gjithë procesin hap pas hapi, por ka ndihmuar dhe lobuar në mënyrë permanente me partnerët, gjë e cila ia lehtësoi akoma më shumë grupit të punës hartimin e këtij materiali. Për këtë gëzon mirnjohjen maksimale e të gjithë stafit që punuan në këtë plan.

Falenderojmë të gjithë qytetarët, të cilët në kuader të dëgjësave publike, moren pjesë dhe ju përgjigjen pyetësorëve online dhe dhanë sugjerimet e tyre, sipas të cilave arritem në konkluzione më të qarta dhe realiste.

Po ashtu falenderojmë URI-n, për kontributin në hartimin e pjesshëm të analizës së gjendjes fillestare si dhe EcoDes për raportin e monitorimit të shërbimit dhe llogaritjen e kostos.

Shprehim mirnjohje, për projektin “Bashki të Forta”, menaxherin të këtij projekti Z. Jacques Merat që është angazhuar personalisht dhe veçanërisht koordinatorin për Lezhën Z. Hekuran Koka që ka asistuar në çdo qelizë të këtij materiali. Gjithashtu falenderojmë shumë edhe Z. Arben Kopliku, ekspert, që asistoi në hartimin e këtij dokumenti.

Fjala përshëndetëse e kryetarit

Të nderuar bashkëqytetarë lezhjan!

Kam nderin të ndaj me ju prioritetet dhe sfidat që më shoqërojnë përgjatë punës time të përditshme, një nga të cilat, ndër më të rëndësishmet është “Menaxhimi i Integruar i Mbetje Urbane”. Si të gjitha qytetet e zhvilluara apo në zhvillim edhe Bashkia Lezhë për shkak të shtrirjes asimetrike territoriale dhe demografike, po përballet me sfiden e administrimit të mbetjeve.

Menaxhimin i mbetjeve, në fakt po e trajtojmë si një nga hallkat më të rëndësishme të zinxhirit të funksionimit të qeverisjes vendore. Kjo nga vetë natyra e brishtësisë që ka ky sektor, i cili direkt apo indirekt afekton të gjithë sektorët e tjerë. Kjo lidhet ngusht me mënyrët e zhvillimit social – ekonomik të qytetit, i cili mbart në gjirin e tij asete të çmueshme natyrore, historike, turistike dhe kulturore.

Duke marrë shkas edhe nga viti që lamë pas, në të cilin treguam qartë, me forcat tona që mbetjet urbane mund të administrohen dhe qyteti mund të mbahet paster, gjë e cila u evidentua qartë nga turistët, bizneset dhe qytetarët, madje për këtë u vlersuam në nivel kombëtar midis të gjitha bashkive si praktika më e mirë e vitit 2020.

Për këtë arsye, bazuar edhe në dokumentet strategjike, konventat ndërkombëtare si dhe ligjet e shtetit shqiptar po ju njoh me Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2021 – 2025. Nëpërmjet të dhënave shkencore dhe mundësisë reale të burimeve njerzore dhe ekonomike, me këtë plan, këtë herë bashkia synon të grumbullojë nëpërmjet kontiniereve dhe të mbulojë të pakten 97% territorit, gjithashtu të ndikojë për gjetjen e skemave efikase për të përmbushur të gjitha detyrimet për reduktimin e mbetjeve që shkojnë në landfill, nëpërmjet riciklimit apo kompostimit.

Kjo është njëra anë, ana tjetër, jo më pak e rëndësishme është sensibilizimi dhe edukimi i popullatës për të funksionuar si një trup i vetëm. Për këtë arsye puna jonë do të vazhdojë në të gjitha kanalet e komunikimit që të jetë sa më afër qytetarëve lezhjan për të arritur objektivin madhor, të mbajmë qytetin tonë të paster.

Duke ju shprehur mirënjohjen time maksimale për bashkëpunimin e deritanishëm, dëshiroj të kërkoj vëmendjen e të gjithë qytetarëve, bizneseve, grupeve të interesit, organizatave dhe institucioneve për angazhimin e tyre në këtë proces, në mënyre të atillë që objektivi i këtij plani të jetë lehtësisht i arritshëm dhe të jetojmë bashkarisht në një mjedis të qetë dhe mbi të gjitha të paster.

Me respekt,

Pjerin NDREU

Kryetari i Bashkisë Lezhë

Akronime

ARM	Agjencia Rajonale e Mjedisit
BE	Bashkimi Evropian
dldp	<i>Decentralization Local Development Programme</i>
GNE	Grupi i Ndërgjegjësimit dhe Edukimit
GP	Grupi i Punës
IKU	Instituti i Kërkimeve Urbane
M&V	Monitorimi dhe Vlerësimi
NJ. A	Njësi administrative
ORM	Objekti i Reduktimit të Mbetjeve
PGM	Pika Grumbullimi të Mbetjeve
PMIM	Plani Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve
QNMR	Qendra e Ndarjes Mbetjeve të Riciklueshme
QQ	Qeveria Qendrore
RGJC	Regjistri i Gjendjes Civil
Rr. Gj. C	Rregjistri i Gjendjes Civile

Parantezë

Që prej vitit 2008, Bashkia Lezhë dhe qytetarët e saj kanë qenë pararojë përsa i përket menaxhimit të mbetjeve dhe pilotimit të aksioneve të reja, në përputhje me direktivat europiane dhe shpesh një hapa para legjislacionit kombëtar. Sivjet (2021) bashkia jonë ka përmbyllur një plan të realizuar deri diku mirë, por edhe me problematikat e veta të shënuara qoftë nga mangësi në zinxhirin tonë të kontrollit, por edhe nga problematika të mëdha. Viti 2020 ishte një vit që e ka shënuar bashkinë dhe komunitetin tonë me dy ngjarje tejet të rënda, sic ishin tërmeti i datës 26 nëntor 2020, i cili dëmtoi qindra banesa dhe institucione, si dhe pandemia më e rëndë e shekullit, covid-19. Këto dy ngjarje kanë shënuar edhe politikat e qeverisjes vendore të Lezhës, dhe për këtë arsye në këtë plan, vit reference do të merret viti 2019, pasi për shkak të ngjarjeve që shënuam më sipër, Këshilli Bashkëtar ka ulur me 30% tarifat për të gjithë bazën paguese të bashkisë, duke bërë që krahasimet e këtij viti të mos qëndrojnë.

Pavarësisht situatës së vështirë, edhe këtë vit (2020) bashkia Lezhë guxoi të ndërmarrë një ndër aksionet më të plota dhe të integruara për menaxhimin e mbetjeve gjatë sezonit turistik, duke u vlerësuar si një nga praktikatat më të mira të qeverisjes vendore për menaxhimin e mbetjeve. Duke u bazuar në këtë eksperiencë ne kemi mësuar shumë, dhe ka një ndikim të madh në hartimin e planit të ri.

Baza për hartimin e këtij dokumenti, Plani për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Urbane 2021 - 2025 (PMIM), është një analizë e zgjeruar e gjendjes aktuale, legjislacioni përkatës, dokumentat strategjike, përlogaritja e disa skenarëve kryesorë në lidhje me planifikimin e viteve në vazhdim, si dhe një bazë e indikatorëve kryesorë për matjen e progresit, bazuar në planin që po mbyllem.

Gjatë analizës së zhvilluar në bashkëpunim me URI dhe BtF, kemi nënvizuar disa problematika kryesore që mendojmë se do të adresohen në PMIM e ri:

- Mbetja e zonës së Ungrejit të pmabuluar me shërbim;
- Nevoja për përmirësim dhe zgjerim të shërbimit gjatë sezonit turistik;
- Koha e parashikuar për sezonin turistik prej 90 ditë nuk pasqyron realisht kohezgjatjen e sezonit;
- Nivel i ulët i riciklimit;
- Kosto të larta të transportit;
- Pasiguria e qëndrueshmërisë së çmimit të depozitimit në landfill;
- Niveli ende jo i mjaftueshëm i mbulimit të kostos nga të ardhurat prej tarifës së shërbimit;

Bashkia e Lezhës është e qartë dhe kupton se menaxhimi i integruar i mbetjeve është një sfidë shumë ambicioze. Duke qenë të vetëdijshëm për sfidat që menaxhimi i integruar i mbetjeve sjell, si dhe duke patur ambicjen e një qyteti të pastër me turizëm të zhvilluar, në PMIM 2021-2025, Bashkia Lezhë do të synojë:

- Arritja e mbulimit me grumbullimin e mbetjeve në të gjithë territorin e aksesueshëm të Bashkisë Lezhë;
- Zgjerimin e shërbimit si në pika grumbullimi, si në frekuencë si në diapazon kohor në zonën turistike, për të gjithë bregdetin, nga rana e Hedhun në Tale;
- Krijimi i bazës së të dhënave për optimizmin e shërbimit;
- Zbatimi i parimit “Ndotësi Pague”, rritja e të ardhurave nga tarifa drejt mbulimit të kostove të shërbimit
- Orientimi drejt menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve nëpërmjet reduktimit, rritjes së riciklimit dhe rikuperimi.
- Bashkëpunimi me të gjithë aktorët për arritjen dhe përgatitjen për implementim të një skenari praktik të realizueshëm në territor për reduktimin e mbetjeve që shkojnë në landfill.

Kosto totale e parashikuar për realizimin e këtij plani, arrin në **398,896,130 Lekë** ose **3,269,640 Euro**.

Përmbajtja

1.	HYRJE	9
2.	IMPAKTI MJEDISOR I PMIM ‘21 -25 NË BASHKINË LEZHË	11
3.	STRUKTURA ADMINISTRATIVE.....	13
3.1	PALËT E PËRFSHIRA, ROLI DHE PËRGJEGJËSITË	13
3.2	GRUPI I PUNËS.....	14
4.	BAZA LIGJORE DHE INSTRUMENTET JURIDIK TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE.....	15
4.1	INSTRUMENTI JURIDIK PËR LARGIMIN E MBETJEVE.....	18
5.	VLERËSIMI I GJENDJES FILLESTARE	20
5.1	PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË	20
5.1.1	Të dhëna gjeografike.....	20
5.1.2	Burimet Natyrore dhe kulturore	22
5.1.3	Të dhëna demografike.....	22
5.1.4	Të dhëna ekonomike	24
6.	GJENDJA E SHËRBIMIT	25
6.1	ANALIZA E GJENDJES SË ZBATIMIT TË PLANIT VENDOR PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETEJVE 2017 – 2021 NË BASHKINË LEZHË.....	25
6.1.1	Aspekti Institucional dhe Ligjor.....	25
6.2	BURIMET NJERËZORE DHE MJETET	25
6.2.1	Burimet njerëzore.....	25
6.2.2	Mjetet	27
6.3	MBLEDHJA DHE TRANSPORTI I MBETJEVE.....	29
6.3.1	Rezultatet e monitorimit të treguesve të performancës në Bashkinë Lezhë.	34
6.4	REDUKTIMI I MBETEJVE	38
6.5	PASTRIMI, LARJA DHE DEZINFEKTIMI.....	39
6.6	DEPOZITIMI DHE TRAJTIMI I MBETJEVE	39
7.	GJENDJA FINANCIARE	41
7.1	KOSTO E SHËRBIMIT	41
7.2	TË ARDHURAT E SHËRBIMIT	42
7.2.1	Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave.....	43
7.3	FINANCIMI I SHËRBIMIT.....	44
8.	KOMUNIKIMI ME QYTETARËT, NDËRGJEGJËSIMI DHE EDUKIMI.....	49
9.	GJENDJA MJEDISORE	49
10.	PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE TË GJENDJES FILLESTARE.....	50
11.	IDENTIFIKIMI I NDRYSHIMEVE DHE PËRMIRËSIMEVE TË MUNDËSHME	52
11.1	Vlerësimi i zonave për zgjerimin e shërbimit dhe përfshirja e praktikave të reja për reduktimin e mbetjeve.....	53

11.2	Rishikimi i projeksioneve për popullsinë dhe sasinë e mbetjeve.....	56
11.3	PROJEKSIONET BAZË TË POPULLSISË, SASISË SË MBETJEVE DHE MJETEVE.....	58
12.	QËLLIMI, OBJEKTIVAT DHE REZULTATET.....	60
12.1	OBJEKTIVAT E PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE NË BASHKINË LEZHË.....	60
12.2	REZULTATET DHE TREGUESIT.....	63
13.	PLANI OPERATIV I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE.....	66
13.1	PLANIFIKIMI TEKNIK I MENAXHIMIT TË MBETJEVE.....	71
	Projeksioni për mbulimin me shërbimin e largimit të mbetjeve.....	71
	Zona 1 e shërbimit.....	74
	Zona 2 e shërbimit.....	77
	Zona 3 e shërbimit.....	78
14.	PLANI FINANCIAR I SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE.....	79
14.1	KOSTO E SHËRBIMIT 2021-2025.....	79
14.1.1	Kosto operative të shërbimit.....	80
14.1.2	Kosto kapitale.....	81
14.1.3	Kosto ndërgjegjësimi.....	82
14.1.4	Kosto shërbimi për njësi.....	83
14.2	PLANIFIKIMI I MBULIMIT TË KOSTOVE.....	84
14.3	BILANCI FINANCIAR.....	88
14.3.1	Shpenzime mbështetëse.....	88

1. Hyrje

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve (PMIM) Urbane për Bashkinë Lezhe është hartuar në përputhje me qëllimet dhe afatet që parashikohen nga ligjet sektoriale të vendit, përfshirë Strategjinë Kombëtare dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. Gjithashtu, përgatitja e këtij plani është në përputhje me afatin e rishikimit të planit pararendës të menaxhimit të mbetjeve të Bashkisë Lezhë duke futur këtu dhe ndryshimet territoriale që vijnë si pasoje e Ndarjes së re Administrativo-Territoriale. Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve¹ i cili është aprovuar nga Parlamenti në fund të nëntorit 2011, adapton plotësisht direktivat e BE-së (75/442/EEC), si dhe përcakton njëherazi hierarkinë e autoriteteve në menaxhimin e mbetjeve, duke ngarkuar me përgjegjësi bashkitë për të hartuar, miratuar dhe zbatuar Planin Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.

Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PVMMNB) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel Vendor, si një dokument/ udhëzues i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Lezhë.

Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qëndrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për menaxhimin e mbetjeve në nivel Vendor. PVMMNU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, reduktimit, dhe impiantet respektive të trajtimit të mbetjeve.

Dokumenti i parashtruar është në vazhdimësi të planit të mëparshëm, të miratuar në vitin 2017, i cili është shtylla mbi të cilën është ndërtuar plani i viti 2021-2025. Analiza e gjendjes fillestare ka për qëllim të kuptojmë se deri në çfarë mase janë realizuar objektivat e planit pararendës 2017-2021, si është situata aktuale, cilat janë problematikat e hasura dhe nevojat e evidentuara për ndërhyrje. Kjo analizë do të fokusohet në territorin e Bashkisë Lezhë, në ato zona ku ofrohet shërbimi i menaxhimit të mbetjeve. Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Të Ardhurave Vendore, drejtoria e Programeve të Zhvillimit dhe Integritimit Evropian në bashkinë Lezhë, si dhe të dhënat që disponojnë nën-kontraktorët e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve janë burimet kryesore ku është bazuar analiza e gjendjes fillestare për planit.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i gjendjes aktuale të shërbimit të largimit të mbetjeve të ngurta urbane, do të rishikohen dhe do të përcaktohen qëllime dhe objektiva për një shërbim cilësor duke realizuar sistemin e matjes së performancës, duke hartuar një plan të detajuar teknik dhe financiar, si dhe në fund duke monitoruar dhe bërë vlerësimin e situatës sipas protokollit të Monitorimit dhe Vlerësimit (M&V).

¹ (Ligji Nr. 10 463, 2011) “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve i ndryshuar”

Ky plan përcakton mënyrën sipas së cilës do të ushtrohet dhe shtrihet funksioni i menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Lezhë. PMIM ofron zgjidhje lokale gjerësisht të pranuar dhe një kuadër të miratuar pune, sipas të cilit mund të merren vendime lidhur me infrastrukturën që nevojitet për të përmbushur zbatimin e praktikave më të mira mjedisore. Plani nxit një pjesëmarrje më të mirë të gjitha palëve dhe paraqet një këndvështrim strategjik të menaxhimit të mbetjeve, duke e vënë theksin në zgjerimin e zonës së shërbimit, në sasinë në rritje të mbetjeve dhe lehtësirat e nevojshme për menaxhimin e mbetjeve.

Gjithashtu, plani përfshin:

- Vlerësim të gjendjes aktuale të shërbimit të largimit të mbetjeve të ngurta urbane;
- Qëllimin dhe objektivat për shërbim cilësor të menaxhimit të mbetjeve;
- Sistemi i matjes së performancës;
- Një plan të detajuar teknik dhe financiar për menaxhimin e integruar të mbetjeve; dhe,
- Protokollin e monitorimit dhe vlerësimit (M&V)

Plani ka për subjekt menaxhinin e Mbetjeve të Ngurta Bashkia (MNB) përfshirë ato shtëpiake dhe të ngashme që gjenerohen nga subjekte të tjera të cilat mblidhen nga bashkia dhe/ose në emer të bashkisë, përfshirë edhe ato mbetje të cilat mund të mblidhen nga subjekte private për qëllime rikuperimit². (Shtojca 2).

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve do të mbulojë hapsirën kohore 2021 - 2025.

Ky plan është bazuar në Planin për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të bashkisë Lezhë 2017-2021, hartuar nga URI me mbështetjen e DLDP, në analizën e thelluar të gjendjes aktuale realizuar nga Bashkia Lezhë me ndihmën e Uri dhe mbështetjen e Bashki të Forta.

Gjithashtu, analiza e skenarëve të rinj dhe llogaritja e kostove të këtij plani janë bere nga Bashkia Lezhë me ndihmën e EcoDes Studio dhe me mbështetjen e projektit Bashki të Forta, në përputhje me VKM-ne 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”

² Ky trajtim harmonizon mënyrën se si mbetjet subjekt i planeve vendore janë përkufizuar respektivisht në ligjin 139/2015 dhe 10 463/2011 duke marrë në konsideratë konceptin e mbetjeve të ngurta bashkiake nga EUROSTAT/OSBE dhe Direktiva Kuader 2008/98/KE dhe Direktivën për Landfill-et (1999 EU)

2. Impakti Mjedisor i PMIM ‘21-25’, në Bashkinë Lezhë

Zbatimi i Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve do të përmirësojë në mënyrë të konsiderueshme impaktin mjedisor nga mbetjet në të gjithë territorin e bashkisë nëpërmjet:

- Zvogëlimit maksimalisht të hedhjes së mbetjeve në mënyrë të pakontrolluar në natyrë dhe veçanërisht në rrjedhat ujore sipërfaqësore;
- Mbrojtjen e vendbanimeve, zonave turistike dhe ekosistemeve nga depozitimi i pakontrolluar i mbetjeve në natyrë.
- Në bashkëpunim më të gjithë aktorët, adaptimi I praktikave të mira, efçente dhe të realizueshme për rikuperimin e burimeve të vlefshme nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit dhe reduktimin e mbetjeve që depozitohen përfundimisht në venddepozitim;

Si rrjedhojë, kontrolli mbi grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin përfundimtar do të kontribuojnë në zvogëlimin e gazeve serë që gjenerohen nga mbetjet.

Në mënyrë të veçantë menaxhimi i integruar i mbetjeve në bashkinë Lezhë do të ndikojë në:

- **Cilësinë e Ujërave Sipërfaqësorë:** shtrirja e mbulimit me grumbullimin e mbetjeve nëpërmjet sistemit të kontenierëve në të paktën 95% të territorit të bashkisë do të minimizojë impaktin negativ të lëngjeve të ndotura që gjerohen nga hedhja e pakontrolluar e mbetjeve përgjatë rrjedhave ujore.
- **Flora, Fauna dhe Biodiversiteti:** Në territorin e bashkisë së Lezhës ndodhen zona / habitatet ujore me ndjeshmëri të lartë si laguna Kune - Vain – Tale, deltat e lumenjve Drin dhe Mat dhe vija bregdetare. Eliminimi i hedhjes së pakontrolluar të mbetjeve në këto zona do të përmirësojë kushtet e jetesës dhe do të mundësojë ruajtjen e vlerave natyrore të faunës, florës dhe biodiversitetit në këto habitate.
- **Peizazhi dhe aspekti vizual:** Çështja kryesore lidhur me këtë aspekt do të jetë aspekti vizual që japin pastërtia nga mbetjet dhe veçanërisht eliminimi i grumbullimeve të pakontrolluara të mbetjeve. Standardi i shërbimit, shpërndarja dhe cilësia e kontenierëve, do të krijojnë mundësinë e eliminimit të vend depozitimeve të pakontrolluar, rrjedhimisht do të përmirësojnë peizazhin dhe aspektin vizual nga mbetjet e shpërndara në territor.
- **Ekonomia dhe jetesa:** Baza e ekonomisë dhe jetesa sigurohen nga turizmi, atraksioni i burimeve natyrore dhe ekonomia bujqësore. Lezha është kthyer në një qendër të atraksionit kulinar mbi bazën e prodhimeve bio. Këto burime rrezikohen nga administrimi irracional i mbetjeve. Kontrolli mbi grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve ashtu siç propozohen në këtë Plan, kanë për synim që të sigurojnë një mjedis të pastër dhe atraktiv i cili mbështetet në zhvillimin e qëndrueshëm dhe miqësor ndaj mjedisit.

- **Shëndeti dhe siguria e komunitetit:** Shëndeti dhe siguria e banorëve të Lezhës mund të ndikohet nga mënyra se si grumbullohen, transportohen dhe trajtohen mbetjet. Standardi i grumbullimit dhe transportit, si dhe mjetet që kërkohen në zbatim të Planit japin siguri për ruajtjen e shëndetit, minimizimin e ndotjes se ajrit dhe zhurmave.
- **Biodiversiteti në zonat e mbrojtura:** Hapësira Kune – Vain – Tale është një zonë e mbrojtur e kategorisë së IV-tët. Sistemi i menaxhimi të mbetjeve siç është planifikuar në këtë dokument, ka marrë në konsideratë në mënyrë të veçantë ruajtjen e biodiversitetit dhe të habitateve në këtë zonë. Megjithëse tregohet kujdes, në këto zona Plani do të sigurojë grumbullimin e rregullt dhe të kontrolluar të mbetjeve, me fokus eliminimin e vend depozitimeve të paligjshme të cilat mund të cenojnë sigurinë dhe kushtet diverse të ekosistemit të këtij habitati.

Në lidhje më ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e impaktit negativ që mund të shkaktohet nga keq menaxhimi i mbetjeve, është e nevojshme që të ndërtohet një Objekt për Reduktimin e Mbetjeve cili do të shërbejë për të adresuar disa prej rreziqeve ndaj mjedisit në territorin e bashkisë. Ndërtimi i këtij objekti duhet të paraprihet nga një Vlerësim i Ndikimit në Mjedis i cili duhet të plotësojë kërkesat e legjislacionit Shqiptar si dhe standardet ndërkombëtare të njohura përgjithësisht dhe Konventat ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

3. Struktura administrative

3.1 Palët e përfshira, roli dhe përgjegjësitë

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane është një përgjegjësi e ndare midis disa palesh siç janë, familjet, bizneset, zyra dhe institucione mbetjet e të cilëve janë të ngjashme me ato të gjeneruara në ambientet e shtëpive. Palët e përfshira dhe përfituesit direkt në këtë proces janë njësitë familjare, komuniteti i biznesit, kompanitë që operojnë me mbetje të riciklueshme dhe autoritetet vendore e qendrore në Lezhë. Performanca e çdo pale në këtë proces do të ndikojë në rezultate pozitive për afrimin drejt menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve i cili do të ulë ndjeshëm sasinë e mbetjeve të cilat përfundojnë në depozitimin final, rrjedhimisht dhe në uljen e kostove të transportit.

Për këtë arsye njësitë familjare, bizneset dhe institucionet dhe të gjitha palët e tjera inkurajohen të marrin mbi vete përgjegjësitë të cilat vijnë me gjenerimin e mbetjeve për të mbrojtur shëndetin dhe mjedisin e përbashkët. Përgjegjësitë e të gjithë palëve dhe përfituesve ndër të tjera, përfshijnë:

- Reduktimin në masën me të madhe të mundshme të gjenerimit të mbetjeve;
- Ndarjen në burim të mbetjeve të njoma (biodegradueshme) nga ato të thata (riciklueshme);
- Bashkëpunimi me autoritetet vendore duke i hedhur mbetjet në kontenierët e duhur sipas instruksioneve të marra nga autoritetet përkatëse, duke respektuar kohën dhe vendin, si dhe duke paguar tarifën e shërbimit;

Megjithatë përgjegjësia e përfituesëve është gjithsesi e limituar deri në momentin e hedhjes së mbetjeve në pikat e grumbullimit të mbetjeve (PGM) të cilat menaxhohen nga kompania e menaxhimit të shërbimit. Kjo e fundit ka përgjegjësinë e parandalimit të shpërndarjes së mbetjeve dhe të depozitimit të tyre në një pikë të autorizuar të depozitimit/trajtimit të mbetjeve. Në këtë kontekst bashkia është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e gjithë sistemit të mbledhjes nga PGM-të deri tek pika e autorizuar e depozitimit/trajtimit të mbetjeve. Autoritetet vendore janë të detyruara që sipas Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve³ të sigurojnë menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane në mënyrën me të mire. Gjithashtu është e rëndësishme që bashkia të krijojë një bazë të dhënash të qartë mbi popullsinë, bizneset, gjenerimin e mbetjeve dhe llojin e tyre duke i përfshirë këto në një proces të plotë auditimi në mënyrë që të bëhet optimizimi i plotë i shërbimit të largimit të mbetjeve.

Për këtë arsye propozohet gjithashtu që Qeveria Qendrore (QQ) të bashkëpunojë me bashkinë në mënyrë që të reformojnë kuadrin aktual të grumbullimit të mbetjeve dhe të konsiderojnë zgjidhje të tilla si rajonizimi nëpërmjet stacioneve të transferimit duke paraprirë depozitimin në destinacionin final të Bushatit. Gjithashtu do të punohet në zgjidhjen njëres nga sfidat kryesore të

³ (Ligji Nr. 10 463, 2011) “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”

planit e cila do të jetë përcaktimi i rolit të mbledhësve informal në sistemin e integruar të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane të Bashkisë Lezhë.

3.2 Grupi i punës

Grupi i Punës për Hartimin e PMIM-së është rezultat i analizës së palëve të interesit të cilët marrin pjesë ose ndikojnë në realizimin e shërbimit të largimit dhe përpunimit të mbetjeve të ngurta urbane nga qyteti i Lezhës.

Me urdhër Nr. 909, date 31.12.2020, të kryetarit të bashkisë, u ngrit grupi i punës për hartimin e këtij plani. Grupi i punës drejtohej nga nënkryetari i bashkisë Lezhe z. Ermal Pacaj, dhe përbëhej nga:

Kryetari Grupit	Ermal PACAJ	Zv/kryetar i bashkisë
Anëtarë	Elson FRROKU	Drejtori, Drejtoria e Integritimit Evropian
	Brikena VUKSANI	Drejtoreshë, Drejtoria Menaxhimit Financiar
	Sidrit CUNI	Supervizor, Drejtoria e Shërbimeve
	Elton ZEFI	Drejtor, Shërbimet Publike
	Indrit TORBAJ	Specialist, Shërbimet Publike
	Zef ZEFI	Inxh. IT, Drejtoria e Programimit
	Naim CARA	Urbanist, Drejtoria e Urbanistikës
	Gentian MALOTAJ	Drejtor, Drejtoria Juridike
	Flora DEDGJONAJ	Përgjegjëse, Shërbimet Publike

Ky grup, pati përgjegjësinë për t'u këshilluar me aktorët e tjerë të interesuar nga hartimi i këtij plani, si dhe harmonizimin me sektorët e tjerë të bashkisë, dhe përafrimin me praktikën e mira dhe legjislativën kombëtare dhe evropiane për të siguruar zbatueshmërisë me efektivitet dhe efikasitet të planit.

Grupi i Punës në bashkinë Lezhë ka punuar ngushtë me stafin e projektit Bashki të Forta, si dhe me ekspertët e URI dhe EcoDes.

Grupi i Punës është mbledhur në seanca të veçanta për të analizuar gjëndjen e shërbimit mbas zbatimit të Reformës Administrative Territoriale, hartimin e politikave të bashkisë të tilla për të synuar përputhjen e planit me kërkesat ligjore dhe objektivat kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, aspektet financiare dhe ato juridike. Grupi i Punës ka diskutuar dhe ka pranuar standardin e shërbimit dhe kostot respektive siç janë parashtruar në këtë Plan.

GP është i vetëdijshëm se disa prej kostove nëpërmjet të cilave do të bëhet e mundur që të arrihen objektivat maksimale të Planit, nuk është e mundur që të realizohen nga buxheti i bashkisë, për

rrjedhojë përgatitja e projekteve dhe identifikimi i burimeve të tjera financiare mbetet një objektivi i rëndësishëm për bashkinë në vitet që do të vijnë.

4. Baza ligjore dhe instrumentet juridik të menaxhimit të mbetjeve

Një nga dokumentat kryesorë që ka hartuar qeveria shqiptare dhe që shtron rrugën për hartimin e planeve lokale për menaxhimin e integruar të mbetjeve, është “Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, Datë 13.01.2020.

Ligji 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" është legjislacioni bazë që përcakton përgjegjësitë e institucioneve qendrore në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Ky ligj është përafshuar plotësisht me Direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008 “Mbi mbetjet”.

Ligji 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, përcakton funksionet e qeverisjes vendore, përfshirë funksionin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta (neni 23 pika 10).

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 319, datë 31.5.2018 Për Miratimin e Masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, është baza kryesore për llogaritjen e kostove dhe të tarifave për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve urbane.

Përveç kësaj, akte të tjera ligjore, të cilat janë zhvilluar më vonë për zbatimin e ligjit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, kanë përgjegjësi të detajuara institucionale ndërmjet institucioneve të qeverisë qendrore, duke përfshirë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe disa ministri të tjera, roli i të cilave lidhet me rryma të veçanta të mbetjeve.

Duke qenë se ky dokument kufizohet në menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe rrymave specifike që këto mbetje përmbajnë, në vijim është përshkruar kuadri institucional i atyre institucioneve në nivel qendror të cilat kanë lidhje drejtpërdrejt me këtë rrymë.

Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta

Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, nr. 10 463, datë 22.09.2011, i ndryshuar, është aprovuar nga Kuvendi i Shqipërisë në fund të shtatorit 2011.

Ligji adapton plotësisht shumicën e direktivave dhe rregulloret e BE-së, dhe siguron bazën e duhur ligjore për përshtatjen e plotë të gjithë legjislacionit të BE-së në sektorin e menaxhimit të mbetjeve.

Përgjegjësia për Menaxhimin e Mbetjeve

Neni 10 i Ligjit parashikon se Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve miratohet në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe të Planeve Rajonale dhe Lokale të Menaxhimit të Mbetjeve.

Neni 15 parashikon se Komiteti për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve do të krijohet në nivel kombëtar, dhe do të jetë përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e menaxhimit të mbetjeve në shkallë kombëtare.

Neni 20 përcakton se shpenzimet për menaxhimin e integruar të mbetjeve mbulohen bazuar në parimin "ndotësi paguan", përveç rastit kur Këshilli i Ministrave apo këshillat vendore vendosin që pjesë të kostos apo gjithë kosto mbulohen nga te tjerë që nuk janë gjeneruesit fillestare të mbetjeve.

Për më tepër i njëjti ligj parashikon ndarjen e autoritetit, funksionet, rolet dhe përgjegjësitë, nga lartë - poshtë, nga qeveria qendrore tek njësitë e qeverisjes vendore. Në veçanti, ligji ngarkon njësitë e qeverisjes vendore me sa më poshtë:

- i. Të miratojë një plan të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planin e Menaxhimit të Mbetjeve të Qarkut,
- ii. Të miratojë rregullat e kontrollit të menaxhimit të mbetjeve të veçanta, duke përfshirë letrën dhe kartonin, qelqin, ushqim dhe kontejnerëve të pijeve, metalin, plastikën apo mbetjet e oborrit,
- iii. Të raportojë çdo vit në qarkun përkatës dhe institucione të tjera për zbatimin e planit të menaxhimit të mbetjeve vendore,
- iv. Të publikojë një draft të Planit dhe ta vere atë në dispozicion të publikut përmes faqes së internetit të qeverisjes vendore,
- v. Të miratojë Planin përkatës duke marrë në konsideratë rezultatet e çdo Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM), përpara miratimit të saj.

PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA

Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta (Strategjia), miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1, Datë 13.01.2020, përcakton politikat e menaxhimit të programit të mbetjeve, që synojnë zhvillimin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit sipas direktivave të BE-së. Ky plan orienton politikat kryesisht në sigurimin e shërbimeve të qëndrueshme për MMN në të gjithë vendin, pakësimin dhe riciklimin

e fraksioneve të mbetjeve, zvogëlimin e numrit të vend depozitimeve të pakontrolluara dhe jo sanitare, si dhe për mbrojtjen e mjedisit.

Sipas këtij plani, masat e nevojshme infrastrukturore vendore në zonën e mbetjeve Shkodër - Lezhë për të garantuar menaxhim modern, të integruar të mbetjeve, janë:

- Garantim i grumbullimit të qëndrueshëm të mbetjeve në nivel vendor/ bashkiak në të gjithë zonën e mbetjeve
- Garantim i mbylljes dhe rehabilitimit të duhur të vendgrumbullimeve ekzistuese në zonën e mbetjeve

Gjithashtu ky plan thekson edhe faktin se nuk ka një sistem standard grumbullimi që mund të zbatohet në të gjithë vendin. Për këtë arsye, në hartimin e planeve vendore të secilës bashki, duhet të merren në konsideratë shumë faktorë për përzgjedhjen e sistemit më të përshtatshëm të grumbullimit:

- Norma e gjenerimit të mbetjeve dhe përbërja e mbetjeve;
- Stuktura e banimit, hapësirë e disponueshme brenda banesave/apartamenteve;
- Gjendja e rrugëve dhe hapësirave të disponueshme në anë të rrugëve dhe në zonat publike;
- Zakonet e banorëve;
- Teknologjitë e disponueshme në vend dhe mundësitë e mirëmbajtjes në rajon të pajisjeve të veçanta.

Vkm Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”,

Vkm Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve” përcakton:

1. Miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe jep udhëzuesin për llogaritjen e kostove për menaxhimin e mbetjeve” dhe “Modelet për llogaritjen e tarifave për:
 - a) menaxhimin e mbetjeve”, përkatësisht, shtojcat 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
 - b) Udhëzuesi dhe modelet, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij vendimi, do t’u shërbejnë njësive të vetëqeverisjes vendore, duke u bazuar në numrin e banorëve dhe të familjeve që kanë në territoret e tyre, sipas ndarjes administrative.

Standardet e Komunitetit Evropian

Kuadri i direktivës së mbetjeve është legjislacioni gjithëpërfshirës nga Bashkimi Evropian që kanë të bëjnë me mbetjet. Direktiva 2008/98/EC mbi mbetjet e miratuar në nëntor 2008 parasheh një

qasje të re të menaxhimit të mbetjeve bazuar në parandalimin e ndikimeve negative të gjenerimit të mbetjeve dhe menaxhimit për ruajtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit, dhe synon kufizimin e prodhimit të mbetjeve si dhe inkurajon përdorimin e mbetjeve si burim përmes riciklimit dhe rikuperimit. Në mënyrë për të arritur këtë qëllim, Direktiva Evropiane ka vendosur si prioritet hierarkinë në vijim për menaxhimin të mbetjeve:

- i. Parandalim
- ii. Përgatitja për ripërdorim
- iii. Riciklimit
- iv. Rikuperime të tjera, p.sh. burim energjie
- v. Asgjësimi

Gjithsesi, për kushtet e Shqipërisë, grumbullimi i mbetjeve është një parakusht, për të vijuar më tej me zbatimin e hierarkisë prioritare sipas Direktivave të BE.

4.1 Instrumenti juridik për largimin e mbetjeve

Propozimi për zgjedhjen e instrumentit ligjor për menaxhimin e shërbimit të grumbullimit, transportit dhe trajtimit të mbetjeve bazohet mbi aktet ligjore si më poshtë e të tjera dhe në vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë.

- ***Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta*** (Strategjia), miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, Datë 13.01.2020
- 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.
- Ligji Nr.8094, datë 21.3.1996, “Për largimin Publik të Mbeturave”; dhe
- Ligji Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publiko privat”;
- VKM Nr. 418 datë 25.06.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”;
- VKM Nr. 608, datë 17.09.2014, “Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”;
- Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar
- Vkm Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”

Zbatimi i këtij Plani është konsideruar të realizohet më sipërmarrje private, e kontraktuar nga bashkia për një periudhë 1-5 vjeçare. Sipërmarrësi privat ose operatori ekonomik privat do të zgjidhet me procedurën e tenderit të hapur në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9643, datë

20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 8094, datë 21.3.1996, “Për largimin Publik të Mbeturinave”.

Sipërmarrësi privat do të respektojë të gjitha specifikimet teknike të cilat bazohen mbi kërkesat e nenit 23 “kushtet e garës”, të ligjit Nr. 8094, datë 21.3.1996, “Për largimin Publik të Mbeturinave”.

Kjo kontratë lidhet pas zbatimit të një procedure prokurimi mbi bazën e fondeve që janë përcaktuar në buxhetin e bashkisë me vendimin e Këshillit Bashkiak. Kontrata lidhet për një afat jo më shumë se 5 vjeçar. Neni 20 i ligjit Nr.8094, si më sipër.

Për kontrata me afat më të gjatë, bashkia duhet ti referohet dhe të zbatojë dispozitat e Ligjit Nr. 125/2013, te ndryshuar me Ligjin Nr. 88/2014, “Për koncesionet dhe partneritetin publiko – privat”, i ndryshuar.


Kontrata me sipërmarrësin/operatorin privat do të përfshijë aktivitete si më poshtë:

- Grumbullimin, fshirjen e territorit të pikës së grumbullimit, dezinfektimin, larjen e kontenierëve;
- Transportin e mbetjeve në vendgrumbullim;
- Depozitimin e mbetjeve për trajtimin përfundimtar në vendgrumbullim.

5. Vlerësimi i gjendjes fillestare
5.1 Përshkrim i përgjithshëm i bashkisë
5.1.1 Të dhëna gjeografike

Bashkia e Lezhës ka një sipërfaqe prej 1,588.4 km² dhe kufizohet me Bashkinë e Lezhës, Vaut te Dejës dhe Shkodrës në veri, në lindje me Bashkinë Mirditë, në jug me Bashkinë e Kurbinit dhe në perëndim me Detin Adriatik me një vijë bregdetare prej 38 km. Territori i Bashkisë së Lezhës përbëhet nga një zonë malore në lindje (65%) dhe zona fushore në perëndim (35%). Shumica e popullsisë jeton në zonat rurale (rreth 60%), ndërsa 40% jetojnë në qendrat urbane.

Lezha shtrihet në pjesën veriperëndimore të vendit, nga Ultësira e Shkodrës në veri e deri në Bregun e lumit Mat në jug, nga Malësia Lezhë-Mirditë në verilindje e lindje e deri në detin Adriatik në Perëndim. Lezha është një zonë me veçori të ndryshme relievi. Territori i Lezhës ndahet në pjesën kodrinore-malore dhe në atë të mirëfilltë fushore. Në pjesën kodrinore-malore përfshihen Kashnjeti, Kreshta, Mali i Velës, Malësia e Lezhës që në rajonizimin e relievit të Shqipërisë bëjnë pjesë në Krahinën Malore Qendrore. Në pjesën fushore ndodhet fusha e Zadrimës në veri (32% e saj shtrihet në rrethin e Lezhës-zona ku ndodhen komunat Dajç dhe Blinisht), fusha e Torovicës në veriperëndim si dhe fusha e Bregut të Matit në jug të territorit të bashkisë, e kufizuar nga Deti Adriatik dhe lumi Mat.






Figura 1: Pozicioni gjeografik i Bashkisë Lezhë (Burimi: Strategjia territoriale e zhvillimit 2015-2030)

Lezha ka një pozicion shumë të favorshëm. Ajo ndodhet në qendër të arterieve kryesore të transportit që lidhin verin me jugun dhe lindjen me perëndimin. Ajo përshkohet nga të gjitha llojet e transportit rrugor, hekurudhor dhe detar. Afërsia e Lezhës me portet kryesore detare e bën këtë një zonë mjaft tërheqëse dhe lehtësisht të arritshme jo vetëm në plan kombëtar, por edhe në plan rajonal për vendet fqinje, si Italia, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Greqia.

Lezha ka rrugë të mira që e lidh atë me Shkodrën, Tiranën, Durrësin dhe Prishtinën dhe përshkohet nga rrjeti hekurudhor që lidh Tiranën me Podgoricën. Gjithashtu në këtë zonë ndodhet njëri prej tre porteve më të mëdhenj të vendit, porti i Shëngjinit si dhe aeroporti ushtarak i Gjadrit, aktualisht jashtë funksionit.

Janë shkurtuar ndjeshëm distancat jo vetëm brenda qarkut dhe me qarqet kufitare, por dhe me Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, përmes superstradës SH2-E761 Tiranë-Shkodër-

Hani i Hotit dhe autostradës A1-E852 Milot-Kukës-Morinë. Ndërtimi i këtyre rrugëve jo vetëm që ka shkurtuar distancat dhe ulur kohën e udhëtimit, por ato kanë ndihmuar në rritjen e bashkëpunimit e shkëmbimeve tregtare, rritjen e numrit të turistëve, zhvillimin e ekonomisë, etj.

5.1.2 Burimet Natyrore dhe kulturore

Si rezultat i pozitës gjeografike, karakteristikat hidrologjike, klimës dhe mikroklimës, relievit, etj, zona ka një biodiversitet të pasur dhe pamje të bukur. Në territorin e Lezhës rrjedhin dy lumenj, lumi i Drinit dhe ai i Gjadrit. Drini i Lezhës fillon në afërsi të fshatit Mjedë të rrethit të Shkodrës, bashkohet me ujërat e lumit Gjadër, kalon përbri Lezhës dhe derdhet në detin Adriatik. Lumi i Gjadrit e përshkon rrethin e Lezhës në 10 km gjatësi. Ky lumë ka një gjatësi prej 40.5km dhe një pellg ujor rreth 120 km². Prurjet mesatare vjetore janë 8.8m³/sek. Gjithashtu në territorin e Lezhës rrjedhin disa përrenj dhe ndodhen disa rezervuarë artificial, të cilat risin shumë potenciale për zhvillimin e bujqësisë në këtë zonë.

Ekosistemet ligatinore bregdetare të Kunes-Vainit janë të shpallur me ligj, zona të mbrojtura natyrore. Në Lezhë ndodhen gjithashtu shumë monumente të natyrës të mara në mbrojtje nga shteti (Rëra e Hedhur; Rrapi i Grykës; Rrepet e Kolshit; Shpella e Hutit; Shpella e Sukës së Vogël; Rivat e Drinit; Këneta e Kashtës; Rrapi i Pirajave (Blinisht); Lisi i Markatomajt; Pylli (dushk, frashër, shkozë), i Shën Eufemisë Kallmet (1 ha).

Në juridiksionin territorial të Bashkisë së Lezhës ka burime të ndryshme kulturore, disa prej të cilave kanë një status të veçantë historik dhe arkeologjik, siç është Kështjella e Lezhës dhe Vendvarrimi i Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, i njohur ndryshe edhe si Memoriali i Heroit tonë Kombëtar. Hapja e Muzeut Etnografik në Bashkinë Lezhë do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e turistëve vendas dhe të huaj në qytet.

Burimet natyrore dhe kulturore të qytetit dhe rajonit e bëjnë këtë zonë mjaft tërheqëse dhe një ndër burimet turistike më të rëndësishme të vendit, zhvillimi i të cilave kërkon një ristrukturim të sistemit të menaxhimit të mbetjeve bashkiake në një nivel me të lartë të cilësisë së shërbimit.

5.1.3 Të dhëna demografike

Popullsia e regjistruar e bashkisë Lezhë është **112,350⁴** banorë, e shpërndarë në **32,283** familje. Ndërkohë sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej **65,633** banorësh dhe **17,186** familjesh. Bashkia ka një densitet popullsie në territorin e saj prej **71** banorë/ km² sipas Regjistrimit Civil dhe **41** banorë/km² sipas Censurit 2011.

⁴ Popullsia sipas regjistrimit të gjendjes civile 1 Janar 2019




Figura 2: Njësitë administrative të bashkisë Lezhë

Tabela me poshtë pasqyron popullsinë e bashkisë sipas NJA-ve duke marrë në konsideratë 3 burime, respektivisht Regjistrin e Gjendjes Civile (RGJC), INSTAT dhe Formulën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE).

Te dhënat e popullsisë të llogaritura sipas MFE do të përdoren si referencë për llogaritjet me qëllim analizën e gjendjes bazë si dhe planifikimin në vijim.

NJA	Popullsia Census 2011		Popullsia RGJC		Popullsia Formula MFE	
	Popullsia	Familje	Popullsia	Familje	Popullsia	Familje
Lezhë	15,510	4,247	31,429	9,653	20,285	5,869
Shëngjin	8,091	2,164	12,798	3,696	9,503	2,624
Ballëdren	6,142	1,536	10,942	2,956	7,582	1,962
Blinisht	3,361	921	5,770	1,555	4,084	1,111
Dajç	3,834	1,077	7,233	2,103	4,854	1,385
Kallmet	4,118	1,124	7,333	1,895	5,083	1,355
Kolsh	4,228	1,135	7,267	2,060	5,140	1,413
Shënkoll	13,102	3,121	16,971	4,716	14,263	3,600
Ungrej	1,587	368	2,916	983	1,985	553
Zejmen	5,660	1,493	9,691	2,666	6,869	1,845
Totali	65,633	17,186	112,350	32,283	79,648	21,717

Tabela 1: Numri i popullsisë sipas njësive administrative

Për efekt të kësaj analize, të llogaritjeve dhe treguesve për Planin Rishikuar të Menaxhimit të Mbetjeve në bashkinë Lezhë, do të merret si bazë popullsia e llogaritur sipas formulës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE). Sipas kësaj formule, popullsia në bashkinë Lezhë rezulton në total rreth 79,648 banorë dhe 21,717 familje.

5.1.4 Të dhëna ekonomike

Pavarësisht se pothuaj të gjitha strategjitë e zhvillimit të njësive lokale theksojnë si sektorët më të rëndësishëm Turizmin dhe Bujqësinë apo kombinimin e tyre, në Lezhë vihen re edhe sektorë të tjerë në rritje dhe që janë të rëndësishëm qoftë për nga numri i bizneseve dhe i të punësuarve në to. Të tillë janë; industritë e lehta si ajo e drurit, e përpunimit të peshkut dhe produkteve bujqësore dhe blegtorale. Një industri tjetër që mund të përmendet është ajo e nxjerrjes dhe përpunimit të materialeve të ndërtimit e rezervave minerare jo metalike. Ky i fundit do të analizohet më tej pavarësisht se do duhen hulumtime më të thella për të vlerësuar saktësisht potencialin e saj edhe në raport me vendin.

Struktura ekonomike e zonës funksionale Lezhë ka ndryshuar që pas viteve 90 e sidomos në qytetin e Lezhës ku degët kryesore të ekonomisë ishin industri të ndryshme si ajo e drurit, letrës, materialeve të ndërtimit (tulla, tjegulla etj.) si dhe industria ushqimore (përpunimi i peshkut). Megjithatë, që pas viteve 90, një nga industritë që vijoi të konsolidohej është ajo e përpunimit të peshkut. Sot ekonomia në qytet është e diversifikuar dhe mbështetet në tregti, shërbime dhe industri si sektorë që punësojnë numrin më të madh të banorëve.

Aktualisht të regjistruar janë 2585 biznese, nga ku 2003 janë të vegjël dhe 582 janë klasifikuar si biznese të mëdha.

Lloji i biznesit	2016	2017	2018	2019	2020
Biznese të vogla	2126	2520	2003	2479	2277
Biznese të mëdha	437	598	582	565	618
Biznese gjithsej	2563	3118	2585	3044	2895

Tabela 2: Numri i bizneseve në Bashki sipas viteve

Motori ekonomik i zonës funksionale si për nga zhvillimi i sektorit privat, i numrit të punësuarve, dhe i përqendrimit të infrastrukturave më të rëndësishme për biznesin është trekëndëshi Lezhë, Shëngjin, dhe Shënkoll. Në këto tre njësi janë të përqendruara edhe aktivitetet kyçe ekonomike për zonën, si ai i peshkimit dhe përpunimit të peshkut, i turizmit, i industrive të ndryshme etj.

6. Gjendja e shërbimit

6.1 Analiza e Gjendjes së Zbatimit të Planit Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2017 – 2021 në Bashkinë Lezhë.

Kjo analizë ka për qëllim të evidentojë se deri në çfarë mase janë realizuar objektivat e planit pararendës 2017-2021, cilat janë problematikat e hasura dhe nevojat e evidentuara të cilat do të adresohen në kuadër të Planit për periudhën 2021 – 2025.

PVMIM i bashkisë Lezhë është një plan ambicioz i cili ka synuar të përafrojë objektivat e bashkisë me standardin e Direktivës Kuadër të mbetjeve 2008/98/EC dhe e mishëruar në ligjin 10 463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Është për tu theksuar se Plani i meparshëm kishte për subjekt menaxhinin e Mbetjeve të Ngurta Bashkiake (MNB), përfshirë ato shtëpiake dhe të ngjashme që gjenerohen nga subjekte të tjera të cilat mblidhen nga bashkia dhe/ose në emer të bashkisë, përfshirë edhe ato mbetje të cilat mund të mblidhen nga subjekte private për qëllime rikuperimit.

6.1.1 Aspekti Institucional dhe Ligjor

Në aspektin institucional dhe ligjor Plani dhe rregullorja shoqëruese janë miratuar nga Këshilli Bashkiak, por ky plan nuk është paraqitur për miratim dhe aprovim në Këshillin e Qarkut për të përmbushur në këtë mënyrë detyrimet ligjore që rrjedhin ng ligji 10463/2011. Kjo mungese vjen si pasojë e faktit se Plani Rajonal për Menxhimin e Mbetjeve për Qarkun Lezhe nuk është miratuar nga Këshilli i Ministrave, për pasojë nuk është bërë e mundur që të realizohet harmonizimi i Planit të bashkisë Lezhë me Planin Rajonal si dhe Planin e Veprimit dhe Strategjinë dhe Planin Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2015 - 2020. Këto mungesa vijnë si pasojë e moszbatimit të ligjin 10463/2011 kryesisht në nivelin e Qarkut dhe Këshillit të Ministrave.

Zbatimi i Planit është konceptuar dhe është vënë në zbatim më sipërmarrje private, të kontraktuar nga bashkia për një periudhë 4 vjeçare. Sipërmarrësi privat ose operatori ekonomik privat të cilët janë zgjedhur me procedurën e tenderit të hapur në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”. Plani ka marrë në konsideratë dhe është hartuar të mbulojë të gjithë territorin e bashkisë Lezhë që ka rezultuar nga amalgamimi i 10 njësive vendore në atë që është sot Bashkia Lezhe si rezultat i reformës Territoriale dhe Administrative të vitit 2015.

6.2 Burimet njerëzore dhe mjetet

6.2.1 Burimet njerëzore

Bashkia Lezhë aktualisht ofron me sipërmarrje private shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Ky shërbim kryhet në bazë të një kontrate 4-vjeçare të nënshkruar me Bashkinë Lezhë.

Numri i administratorëve, specialistëve të fushës dhe mbikëqyrësit e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, sipas organizimit të njësisë vendore, jepen në tabelën e mëposhteme. Të dhënat janë mbledhur gjithashtu dhe për numrin e punëtorëve dhe të shoferëve në këtë shërbim, gjithsej 55 punonjës, prej të cilëve 18 janë shofer për të gjithë Bashkinë Lezhë.

Ata janë të punësuar nga shoqëritë sipërmarrëse. Ndërkohë 3 supervizorë për të tre zonat e shërbimit, të cilët janë trajnuar për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave sipas rregullores së Monitorimit për Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta i hartuar nga Instituti i Kërkimeve Urbane (URI) në korrik të vitit 2017, janë vënë në dispozicion për të monitoruar shërbimin e ofruar nga operatorët.


Kjo rregullore përmban në mënyrë të detajuar të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë për të gjithë aktorët e përfshirë në ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Lezhë. Përveç supervizorëve në mbikëqyrje të shërbimit janë përfshirë edhe administratorë të njësisë administrative dhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike pranë Bashkisë.

Të dhënat për numrin e punonjësve të përfshirë në ofrimin e shërbimit, për popullsinë që përfiton shërbim sipas zonave, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

	Zona 1 (Lezhë- Shëngjin)	Zona 2 (Shënkoll-Zejmen- Kolsh)	Zona 3 (Balldren-Kallmet- Blinisht-Dajç- Ungrej)
Administratë	4		
Drejtues dhe përgjegjës teknik	2	2	2
Mbledhje	14	8	8
Transport	8	3	3
Depozitim, trajtim	0	0	0

Table 1 Burimet njerzore të angazhuara për menaxhimin e mbetjeve

Gjithashtu pjesë e administratës janë dhe administratorët e njësisë administrative të cilët në total janë 9. Administratori i Nj.A mbikëqyr zbatimin e shërbimit nga operatori i shërbimit në territorin e njësisë administrative, njofton supervizorin e shërbimit, ose, në raste kur është e nevojshme, drejtpërsëdrejti Drejtorin e Shërbimeve Publike në Bashki, për shkelje të standardeve ose probleme të zbatimit të shërbimit që ai ndesh dhe harton proces verbalet përkatëse.



Grafiku 1: Eficienca e burimeve njerëzore kundrejt numrit të popullsisë së shërbyer, Lezhë 2018

Nga grafiku shikojme se ndersa bashkia ka angazhuar kater punonjes te administrates per shërbimin e menaxhimit te mbetjeve, raporti i grupit i punes ne terren kundrejt popullsisë totale është nje punonjes per 1.358 banore te sherbyer.

Ne bashkine Lezhe, megjithatë, administratorët e njësisë administrative janë të angazhuar ne monitorimin dhe supervizimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve ne njësinë administrative qe ata administrojnë dhe per rjedhoje përgjegjshmëria dhe monitorimi i shërbimit është me i larte.

6.2.2 Mjetet


Kontejnerë

Bashkia Lezhë e ka ofruar shërbimin nëpërmjet një totali prej 960 kontejnerë plastik, me vëllim 1.1 m³, të cilët janë në pronësi të kompanive që janë kontraktuar për ofrimin e shërbimit. Këta kontejnerë janë të vendosur në 565 pika të përcaktuara nga bashkia për grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane, kryesisht me nga dy dhe tre kontejner për një pikë grumbullimi. Numri i tyre shprehet si në tabelën në vijim:

Bashkia Lezhë	Kontejnerë	Kontejnerë në gjendje të mirë (nr/%)	Kontejnerë në gjendje të dëmtuar	PGM	Vite pune të kontejnerëve
Gjithsej	960	910/95%	50/5%	565	4

Tabela 3: Gjendja e kontejnerëve të shërbimit

Referuar të dhënave nga terreni, rezulton se rreth 50 kontejnerë të shpërndarë në bashkinë Lezhë janë të dëmtuar. Duke ju referuar faktit që bashkia Lezhë ka kontraktuar shërbimin gjate viteve 2017-2018 dhe ne specifikimet teknike te ofrimi te shërbimit është kërkuar që kontenierët te jene te rinj, gjë që ka ndikuar ne numrin e ulet te kontenierëve te dëmtuar.



Grafiku 2: Shpërndarja e kontejnerëve për numrin e banoreve që marrin shërbim.

Bashkia ka në shërbim një numër të konsiderueshën kontejnerësh që ndikon në një nivel të përmirësuar të shërbimit, ndonse ajo që vërehet nga monitorimi në terren, operatorët nuk i kanë respektuar të gjitha specifikimet teknike sipas standardit të kërkuar, ngjyra e kontejnereve, kapakët, apo vendosja e etiketave udhëzese vetngjithëse.

Kamionët

Per ofrimin e shërbimit ne bashkinë Lezhë janë angazhuar nje total prej 10 kamionesh prej te cilëve 7 jane kamionë teknologjik dhe 3 jane kamionë me veteshkarkim. Keta kamionë janë ne pronësi te operatoreve private te ofrimit te shërbimit qe operojnë ne 3 zonat e shërbimit ne bashkinë Lezhë. Përsa i përket jetës së përdorimit të kamionëve, kamionet janë te prodhuar te gjithë pas vitit 2010 duke qene se nje nga kërkesat e specifikimeve teknike te ofrimi te shërbimit ka qene pikërisht viti i prodhimit te kamionit jo me herët se 2010.

	Zona 1 (Lezhë-Shëngjin)	Zona 2 (Shënkoll-Zejmen-Kolsh)	Zona 3 (Balldren-Kallmet-Blinisht-Dajç-Ungrej)
Nr. kamionëve	3+1	2+1	2+1
Teknologjia	Teknologjik/ vetëshkarkim	Teknologjik/ vetëshkarkim	Teknologjik/ vetëshkarkim
Tonazhi	10 ton/ 3 ton	12 ton/7 ton	12 ton/ 3 ton
Viti prodhimit	>2010	>2010	>2010
Vite pune	>7	>7	>7

Tabela 4: Gjendja e kamionëve të shërbimit

6.3 Mbledhja dhe transporti i mbetjeve

Shërbimi i mbledhjes dhe transportit të mbetjeve në Bashkinë Lezhë aktualisht është i organizuar nëpërmjet 3 zonave të shërbimit. Zona e parë mbulon zonën urbane, praktikisht në Njësinë Administrative të Lezhës dhe në Njësinë Administrative Shëngjin, zona e dytë përfshin njësitë administrative Shënkoll, Zejmen dhe Kolsh dhe zona e tretë përfshin njësitë administrative Balldre, Kallmet, Blinisht, Dajç dhe Ungrej. Përsa i përket mbulimit me shërbim njësi administrative Ungrej aktualisht nuk mbulohet me shërbim. Popullsia totale që merr shërbim në të gjithë bashkinë Lezhë është rreth 97% duke marrë në konsideratë se nëntë nga dhjetë njësi administrative marrin shërbim në të gjithë territorin e tyre.

Popullsia që merr shërbim	Popullsia sipas MFE	Përqindja e popullsisë që merr shërbim	Popullsia që merr shërbim sipas MFE	Nr. Familjeve që marrin shërbim
Lezhë	20,285	100%	20,285	5,869
Shëngjin	9,503	100%	9,503	2,624
Balldre	7,582	100%	7,582	1,962
Blinisht	4,084	100%	4,084	1,111
Dajç	4,854	100%	4,854	1,385
Kallmet	5,083	100%	5,083	1,355
Kolsh	5,140	100%	5,140	1,413
Shënkoll	14,263	100%	14,263	3,600
Ungrej	1,985	0%	0	0
Zejmen	6,869	100%	6,869	1,845
Totali	79,648	97%	77,663	21,164

Tabela 5: Gjendja e mbulimit me shërbim në bashkinë Lezhë


Te dhënat paraqesin se, në territorin e bashkisë Lezhë janë të shpërndarë në total 960 kontenerë nëpërmjet të cilëve bashkia ofron një shërbim në nivelin 97 % dhe me frekuencë e cila varion nga shtatë here në javë për zonën e Lezhës dhe Shëngjinit (gjatë verës) në dy here në javë në zonat rurale të bashkisë. Konkretisht situata e kontenerëve dhe % e mbulimit me shërbim është si më poshtë:

NJA	Frekuenca (dite/javë)	Nr. Kontejnerëve	Mbulimi me shërbim (%)
Lezhë	7	200	100 %
Shëngjin	3 here në javë gjatë dimrit/2-3 here në ditë në periudhën e verës	143	100 %
Balldre	3	141	100 %
Kallmet	2	83	100 %
Zejmen	2	120	100%
Shënkoll	3	111	100 %

Dajç	1	57	100 %
Blinisht	1	48	100 %
Kolsh	1	57	100 %
Ungrej	-	-	0%
Total		960	97%

Tabela 6: Zgjerimi i shërbimit për efekt të ndryshimeve në buxhetin 2020, Lezhë

Numri total i kontenerëve të shpërndarë në territorin e bashkisë Lezhë është i mjaftueshëm për mbulimin e shërbimit të popullatës në këtë territor.



Grafiku 3: Paraqitja grafike e mbulimit me shërbim, Lezhë 2018

Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve shtëpiake në bashkinë e Lezhës kryhet në 3 zona të shërbimit nëpërmjet dhjetë itinerareve të ndryshme si më poshtë:

1. Zona 1 e shërbimit, katër itinerare me gjatësi totale 112 kilometra të cilat mbulojnë qytetin e Lezhës dhe të Shëngjinit;
2. Zona 2 e shërbimit, tre itinerare me gjatësi totale 119 kilometra të cilat mbulojnë njësitë administrative, Kolsh, Zejmen Shënkoll;
3. Zona 3 e shërbimit, tre itinerare me gjatësi totale 110 kilometra të cilat mbulojnë njësitë administrative, Kallmet, Ballëdre, Blinisht, Dajç;

Duke ju referuar planit aktual të menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Lezhë në zonën e tretë të shërbimit është i përfshirë dhe janë bërë dhe llogaritjet e duhura për ofrimin e shërbimit në njësinë administrative Ungrej ku aktualisht administrative nuk ofrohet shërbimi i menaxhimit të mbetjeve. Problemet që shoqërojnë shërbimin kanë të bëjnë me cilësinë dhe respektimin e standardeve të vendosura në planin ekzistues i cili synon që gradualisht të vendosë në mënyrë të qëndrueshme sistemin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, veçanërisht mbetjet e riciklueshme.



Figura 3: Vendorsje korrekte e kontejnereve



Figura 4: vendorsje e gabuar e kontejnereve

Tabela ne vijim pasqyron një përmbledhje e tregueseve kryesore te mbulimit me shërbimin e grumbullimit, transportit te mbetjeve shtëpiake/urbane ne bashkinë Lezhë.

NJ.Q.V	Popullsia,	Zona urbane e rurale, ku ofrohet shërbimi	Popullsia qe përfiton shërbimin	% mbulimit te shërbimit te mblledhjes se mbet.	Sasia ditore e prodhimit te mbetjeve mbi popullsinë totale	Sasia vjetore e prodhimit te mbetjeve	Sasia ditore e mbetjeve urbane qe G+T ne dite	Distanca e transportit deri te vend depozitimi	Nr. i kont.
	Rezidentë efektive (viti 2019)								
	Nr.		Nr.	%	kg/dite	Ton/vit	Ton/dite	Km	Nr.
Lezhe	20,285	Urbane	20,285	100%	13,866	5,061	14	25	200
Shëngjin	9,503	Urbane	9,503	100%	6,496	2,371	6	31	143
Ballëdren	7,582	Rurale	7,582	100%	2,908	1,061	3	21	141
Blinisht	4,084	Rurale	4,084	100%	1,566	572	2	14	48
Dajç	4,854	Rurale	4,854	100%	1,862	680	2	8	57
Kallmet	5,083	Rurale	5,083	100%	1,950	712	2	25	83
Kolsh	5,140	Rurale	5,140	100%	1,971	720	2	29	57
Shënkoll	14,263	Rurale	14,263	100%	5,470	1,997	5	36	111
Ungrej	1,985	Rurale	-	0%	-	-	-	37	0
Zejmen	6,869	Rurale	6,869	100%	2,635	962	3	36	120
Shuma	79,684		77,663	97%	38,723	14,134	39		960

Tabela 7: Përmbledhje e te dhënave te shërbimit te menaxhimit te mbetjeve për bashkinë Lezhë

Normativa e prodhimit te mbeturinave urbane “kg/dite/banor” është llogaritur si me poshte:

Njesia Administrative Lezhë dhe Shengjin

- 0,7 kg/dite/banor

Njesite Administrative te tjera

- 0,4 kg/dite/banor

Tipi i të dhënave	Vlera
Numri i popullsisë gjithsej, ne bashkine Lezhë	79.684
Numri i popullsisë që merr shërbim	77.663
% popullsisë që merr shërbim aktualisht	97%
% e popullsisë që do të marrë shërbim pas përmirësimit	99%
% e territorit të mbuluar me shërbim	99%
Sasia e mbetjeve të gjeneruara (e vlerësuar)	14.412 ton/vit
Sasia e mbetjeve të mbledhura (ton/vit)	14.134 ton/vit
Mbetje të gjeneruara (kg/banorë/ditë)	0,4 kg/banor/dite dhe 0.7 kg/banor/dite
Frekuenca e mbledhjes së mbetjeve në secilën nga zonat e shërbimit	
a. Zona 1 (Urbane)	3 - 7 herë/javë
b. Zona 2 (Rurale)	2 -3 herë/javë
c. Zona 3 (Rurale)	2 -3 herë/javë

Tabela 8: Të dhëna mbi ofrimin e shërbimit




Figura 5: Harta treguese e mbulimit me shërbim të territorit të bashkisë Lezhë

Sipas raportit të Diagnostikimit për Bashkinë Lezhë, në qytet arrihet të mblidhet pothuajse plotësisht sasia e mbetjeve, kundrejt vetëm 3% e totalit e cila gjenerohen në njësinë administrative Ungrej. Ndërkohë, shërbimi kryhet në një frekuencë 7 herë/javë në qytetin e Lezhës, varion nga 2 deri në 3 herë/javë në njësite të tjera.

6.3.1 Rezultatet e monitorimit të treguesve të performancës në Bashkinë Lezhë

Në figurat e mëposhtme jepet në mënyrë të përmbledhur krahasimi i treguesve të performancës për bashkinë Lezhë të llogaritura në vitin 2016, periudhë kur u hartua PLMIM për bashkinë Lezhë me ato të llogaritura për vitin 2020.

Treguesi C1: Mbulimi i zonës me shërbim

Për llogaritjen e këtij treguesi nevojitet sasia e mbetjeve të gjeneruara, e cila është e llogaritur dhe sasia e mbetjeve të depozituara në landfill, e cila është marrë nga evidencat në landfill. Bashkia Lezhë, siç deklarohet në PLMIM në vitin 2016 mbulonte rreth 66% të territorit me shërbim. Ndërkohë në vitin 2019, ky tregues ka një rritje të ndjeshme dhe tashmë bashkia mbulon 87% të territorit me shërbim. Kjo rritje mund të ketë ardhur: (i) si pasojë e zgjerimit të shërbimit në territor, (ii) si pasojë e intensifikimit të shërbimit në po të njëjtën shtrirje (iii) si pasojë e aksioneve të

pastrimit që mund të jenë zhvilluar përgjatë këtij viti në bashki. Një gjë është e qartë që sasia e mbetjeve të depozituara në landfill përgjatë vitit 2019 është më e madhe se ajo e vitit 2016.




Figura 7: Rezultatet e treguesit – Mbulimi i zonës me shërbim për çdo NjA të bashkisë Lezhë

Po të bëjmë një analizë më të detajuar për të kuptuar më mirë shifrat, duke parë këtë tregues për çdo zonë të shërbimi, shohim që pothuajse në të gjitha zonat ky shërbim ka pësuar një rritje. Gjithashtu, bashkia pas miratimit të planit e ka zgjeruar shërbimin pothuajse në të gjitha NjA, ndërkohë që sfida për bashkinë është shtrirja e këtij shërbimi edhe në Kolsh dhe Ungrej.

Treguesi C2: Pastërtia e territorit të bashkisë

Për të kuptuar më mirë treguesin e analizuar më sipër “Mbulimi me shërbim” dhe për t’i dhënë atij një kuptim më plotë sesa thjeshtë një vlerë numerike, nëpërmjet treguesit të rradhës, “Pastërtia e territorit të bashkisë”, i cili është një tregues cilësor, duam të analizojmë faktin sesi qëndron shtrirja e këtij shërbimi në territor në raport me cilësinë e tij.

Ky tregues përfshin vlerësimin e 5 kriterëve siç prezantohen në Figurën 4, dhe është vlerësuar sipas metodologjisë me pikë të prezantuar në Aneksin 1 nga monitoruesit e shërbimit në drejtorinë e shërbimeve publike në Bashkinë Lezhë. Ky tregues gjithashtu po në të njëjtën mënyrë mund të vlerësohet edhe nga auditues të jashtëm.




Figura 8: Rezultatet e treguesit – Pastërtia e territorit për çdo NjA të bashkisë Lezhë

Cilësia e shërbimit e ofruar nga bashkia Lezhë në të gjithë territorin e saj në vitin 2019 është në kufirin ndërmjet cilësisë së ulët me atë mesatare. Këtë tregues nuk kemi mundësi ta krahasojmë me vitin 2016, pasi në atë periudhë ky tregues nuk është matur me të njëjtën metodologji që ne propozojmë, si në aneksin 1. Gjithësesi, ajo që mund të shohim nga analizimi i këtij treguesi është që cilësia e shërbimit në zonën e parë është në kufirin ndërmjet cilësisë mesatare dhe të lartë, ndërsa në dy zonat e tjera cilësia e shërbimit është në zonën e kuqe, pra është një cilësi e ulët. Duke analizuar vlerësimin e kritereve, kjo cilësi mesatare i atribuohet kryesisht:

- (i) infrastrukturës së dëmtuar të grumbullimit, e cila është e amortizuar dhe ka nevojë për t’u zëvendësuar (mungese mjetesh financiare) dhe
- (ii) prezencës së mbetjeve në zonat periferike, si pasojë e pamundësisë së shtrirjes së shërbimit në këto zona (mungese infrastrukture dhe mjetesh financiare)

Treguesi C3: Kënaqësia e banorëve

Matja e përceptimit të publikut mund të gjenërohet në dy mënyra. Në mënyrë indirekte ai mund të matet me raportin e ankesave të qytëtareve që lidhen me cilësinë e shërbimit të rregjistruara përgjatë një muaji, kundrejt numrit të ankesave të cilat janë zgjidhur po gjatë atij muaji. Gjithashtu përceptimi i banoreve në lidhje me cilësinë e shërbimit mund të matet edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes intervistave me pyetësorë. Një analizë e detajuar e matjes së përceptimit të banorëve për cilësinë e shërbimit përmes metodës me pyetësorë është dhënë në pikën 4.2. Në figurën e mëposhtme jepet në mënyrë të përmbledhur rezultatet e këtij treguesi, i cili është matur për herë të parë për vitin 2020 në të gjitha NjA të bashkisë Lezhë përmes anketimit me pyetësor përmes faqeve të internetit të dedikuar për realizimin dhe analizimin e anketave të ndryshme (survey monkey).


TREGUESI	BASHKIA LEZHE 2016			BASHKIA LEZHE 2019		
KENAQESIA E BANOREVE	N/A					
	KENAQESIA E BANOREVE	ZONA 1	ZONA 2	ZONA 3		
	2016	N/A	N/A	N/A		
	2019	E mesme	E ulët	E mesme		

Figura 9: Rezultatët e treguesit – Kënaqësia e banoreve për çdo NjA të bashkisë Lezhë

Nga përgjigjet e grumbulluara në rang bashkie rezulton se 23% e të anketuarve e vlerësojnë këtë shërbim me cilësi të lartë, 43% e të intervistuarve pranojnë se cilësia e shërbimit është e mesme dhe vetëm 34% pranojnë që cilësia e shërbimit është e ulët. Një analize me e detajuar e vlerësimit jepet në piken 4.2.2 të këtij raporti, ndërkohe që vlerësimi për çdo zonë jepet në figurën e mëposhtme.




Figura 10: Rezultatet e vlerësimit me notë të banorëve në çdo zonë shërbimi të bashkisë Lezhë

6.4 Reduktimi i mbetjeve

Plani i Bashkisë Lezhë ka synuar reduktimin e mbetjeve nëpërmjet grumbullimit të diferencuar të mbetjeve të riciklueshme duke nisur në fillim në zonat urbane, dhe gradualisht duke u përhapur edhe në pjesët e urbanizuara të fshatrave.

Në terma të përgjithshëm bashkia ka planifikuar të ndajë për riciklim rreth 50% të sasisë së mbetjeve të riciklueshme (4 rrymat, leter/karton, metale, plastikë dhe qelq) që në terma absolut përkon me një sasi prej 1,904 ton/vit kundrejt 5,602 ton/vit që përbëjnë mbetjet e riciklueshme.

Këto rezultate do të arriheshin nëpërmjet vendosjes së një sistemi të grumbullimit të diferencuar dhe sigurimit të stacioneve të selektimit nga operatorët e shërbimit.

Nga analiza rezulton se vetëm operatori i Zonës së II-të ka bërë operacional një stacion selektimi për mbetjet e riciklueshme dhe raporton se ndan për riciklim një sasi të përafërt me atë të planifikuar. Në dy Zonat e tjera këto aspekte të planit nuk janë zbatuar.

Në këtë aspekt, për të nxitur ndarjen në burim dhe riciklimin, Plani po parashikon ristrukturimin dhe rivënien në funksionim të Qendrës ekzistuese për selektimin e mbetjeve të riciklueshme ose zgjidhje të tjera alternative, si psh angazhimi i familjeve të skemës së ndihmës ekonomike, etj. Ky aspekt i planit nuk është zbatuar pasi bashkia vendosi mbylljen e kësaj qendre dhe ndryshimin e destinacionit.

Versioni i qëndrueshëm i reduktimit të mbetjeve do të ishte planifikimi i ndërtimit të një stacioni të ndërmjetëm ose Objekti për Rikuperimin e Mbetjeve i cili do të mundësonte selektimin dhe paketimin e rrymave të mbetjeve për riciklim dhe kompostimin e mbetjeve të biodegradueshme.

Në lidhje me ngritjen e kësaj qendre paraprakisht kishte një dakordësi edhe me qeverinë qendrore, por kjo qendër nuk është realizuar dhe duke u referuar me draft Masterplanin Kombëtar nuk ka gjasa që të zhvillohet pasi këto aspekte parashikohen që të zhvillohen në landfill-in e Bushatit, përveçse nëse bashkia Lezhë parashikon që ta financojë këtë objekt me burimet e veta financiare, ose nëse operatorët do të angazhohen vetë për ndarjen e mbetjeve në pikat e tyre.

Treguesi M1: Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve

Për llogaritjen e këtij treguesi nevojitet sasia e mbetjeve të grumbulluar në mënyrë të veçantë, krahasuar me totalin e mbetjeve të grumbulluar. Bashkia Lezhë ka qënë bashkia pioniere në drejtim të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve. Në këtë bashki ka pasur disa projekte, të cilat janë materializuar edhe me investime në infrastrukturë në këtë drejtim. Kështu në vitin 2016, kur u hartua plani lokal për menaxhimin e mbetjeve, në bashkinë Lezhë, në qendrën për selektimin e

mbetjeve të riciklueshme deklarohet një norme grumbullimi prej 560 ton/vit mbetje të riciklueshme, afërsisht 7% e totalit të mbetjeve që grumbullohen në zonën e parë.

Aktualisht në bashkinë Lezhë kjo iniciativë është zbehur shumë dhe është drejt zhdukjes. Në vitin 2019 në zonë e dytë të shërbimit referohen disa vlera të ulta për një grumbullim të diferencuar të mbetjeve, kryesisht letër karton dhe mbetje plastike. Në figurën e mëposhtme paraqitet skematikisht analizimi i këtij treguesi. Për fat të keq bashkia Lezhë për këtë tregues ka një rënie të konsiderueshme krahasuar me vitin 2016. Në zonën e parë dhe të tretë të shërbimit deklarohet se grumbullimi i diferencuar nuk ekziston. Përfundimisht në zonë e dytë, e cila deklarohet një sasi shumë të vogël të grumbullimit të diferencuar krahasuar me totalin e mbetjeve që grumbullohen në këtë zonë.




Figura 11: Rezultatet e treguesit – Grumbullimi i diferencuar për Bashkinë Lezhë

6.5 Pastrimi, larja dhe dezinfektimi

Bashkia Lezhë kryen dezinfektim të kontejnerëve apo larje të tyre si dhe dezinfektim të pikave të grumbullimit të mbetjeve ku kontejnerët ndodhen. Gjatë shërbimit të mbledhjes së mbetjeve, këta të fundit zhvendosen nga vendndodhja për tu lare dhe dezinfektuar në ambientet e kompanive të cilat ofrojnë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve për secilën zonë. Dezinfektimi i kontejnerëve dhe pikave të grumbullimit kryhet sipas një grafiku të caktuar pune.

6.6 Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve

Ashtu siç është përcaktuar në strategjinë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve, Bashkia Lezhë është pjesë e zonës së mbetjeve Shkodër - Lezhë, të cilat kanë të përcaktuar si pikë fundore për depozitimin e mbetjeve urbane Landfillin e Bushatit. Depozitimi i mbetjeve të grumbulluara në bashkinë Lezhë depozitohen në landfillin e Bushatit nëpërmjet kontratave që kompanitë që ofrojnë shërbimin kanë lidhur me Landfillin Bushat sh.a.. Te gjitha mbetjet të grumbulluara në secilën prej zonave të shërbimit transportohet për në landfill me anë të makinave të grumbullimit.

Landfilli i Bushatit ndodhet rreth 25 km larg qendrës së qytetit të Lezhës. Landfilli është bërë operacional në vitin 2010, i projektuar në standardin e një landfilli sanitar që në kohën e ndërtimit ishte në pronësi të komunës Bushat e që pas reformës territoriale dhe administrative të vitit 2015 landfilli kaloi në pronësi të bashkisë Vau i Dejës. Për të operuar landfillin, është krijuar një kompani aksionare që është në pronësi të 100% të bashkisë, megjithëse Landfilli është ngritur si një strukturë rajonale për të mbledhur mbetjet nga të gjitha bashkitë e qarqeve Shkodër dhe Lezhë. Operatorët të cilët realizojnë operacionet e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve u dorëzojnë supervisorëve të shërbimit në zonat përkatëse të menaxhimit të mbetjeve situacionet e ofrimit të shërbimit të cilat përmbajnë dhe sasinë e mbetjeve të depozituara në landfill.

Treguesi M2: Trajtimi i mbetjeve në përputhje me legjislacionin

Ky tregues mat shkallën e mbetjeve që shkojnë në një impiant të trajtimit ashtu siç parashikohet në legjislacionin. Ai synon të evidentojë atë sasi të mbetjeve, e cila depozitohet në mënyrë ilegale ose në venddepozitime pa leje dhe kontroll mjedisor. Ky tregues matet duke bërë raportin e sasisë së mbetjeve që depozitohen në landfillin e Bushatit me sasinë e mbetjeve që gjenerohen. Praktikiisht, ajo sasi mbetjesh e cila nuk grumbullohet është e destinuar të depozitohet ose të digjet në mjedise të hapura në kundërshtim me legjislacionin.




Figura 12: Rezultatet e treguesit – Grumbullimi i diferencuar për bashkinë Lezhë

Në bashkinë Lezhë trajtimi i mbetjeve të grumbulluara në të treja zonat e shërbimit bëhet në landfillin e Bushatit. Treguesi i qëndrueshmërisë mjedisore për bashkinë Lezhë është i lartë dhe i pandryshueshëm, që nga viti 2016 në vlerën mesatarisht 90%. Ky trend vërehet pothuaj në të gjitha zonat e shërbimit dhe arsyeja kryesore lidhet me faktin e zgjerimit të shërbimit dhe grumbullimit e transportimit, gjithnjë e më shumë të mbetjeve në landfillin e Bushatit.


7. Gjendja Financiare

7.1 Kosto e shërbimit

Analizimi i kostove dhe realizimit të mbulimit të këtyre kostove nëpërmjet tarifës së shërbimit nuk është e lehtë për shkak të tarifës së përbashkët të aplikuar për disa shërbime siç është ai i largimit të mbetjeve, pastrimit, gjelbërimit ndriçimit dhe dekorit. Sidoqoftë, sipas përlllogaritjeve, tarifa e menaxhimit të mbetjeve përbën 62% të tarifës së aplikuar për shërbimet publike në Bashkinë Lëzhë.

Nga të dhënat e bashkisë marrim kostot e mëposhtme për njësi të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në vitin 2020. Sasia mesatare e gjenerimit të mbetjeve për banor/ditë e cila përdoret si bazë e përlllogaritjes së kostos operative për ton/mbetje/vit.

Në bashkinë e Lezhës kosto gjithsej e këtij shërbimi është e përbërë: nga zëri i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore të punonjësve 16%, nga zëri shpenzime të tjera për materiale pune dhe të tjera për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve 1%, dhe nga zëri i menaxhimit të mbetjeve 83% i cili është i kontraktuar në 3 operatore të cilët operojnë në 3 zona shërbimi.



Grafiku 4: Grafiku i shpenzimeve sipas zërave për vitin 2020

Në grafikun e mësipërm janë paraqitur shpenzimet e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve sipas zërave ku shihet qartë se pjesën më të madhe të shpenzimeve e zëri i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në të cilën përfshihen grumbullimi dhe depozitimi i mbetjeve në landfill. Nga ana tjetër në tabelën e mëposhtme janë paraqitur kostot e shërbimit në vlera absolute si dhe kostot njësi përkatëse për banor në vit dhe ton në vit.

Kostot e shërbimit [2019]	Vlera ne 000 lek
Shpenzimet e realizuara të shërbimit (lekë/vit)	78416
Sasia e mbetjeve e mbledhur (ton/vit)	14,134
Banorë që marrin shërbim banorë	77,663
Kosto operative e shërbimit lekë/ton/vit	4,742
Kosto operative e shërbimit (lekë/banor/vit)	863

Tabela 9: Kosto për njësi e realizimit të shërbimit.

7.2 Të ardhurat e shërbimit

Bashkia ka një bazë të dhënash për të gjithë klientët që marrin shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Aktualisht kjo baza të dhënash është e ndare midis dy baza të dhënash, e pare është baza e të dhënave të ndërmarrjes Ujësjellës-Kanalizime Lezhë dhe e dyta sipas bazës së të dhënave të zyrës së gjendjes civile.

Tarifa e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve u faturohet rregullisht bizneseve, institucioneve dhe familjeve nëpërmjet sistemit të faturimit të ndërmarrjes Ujësjellës-Kanalizime Lezhë. Në vitin 2017 bashkia akomodoi sistemin e faturimit dhe grumbullimit të të ardhurave për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në sistemin e faturimit të grumbullimit të të ardhurave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime. Megjithatë në bashki është një numër i konsiderueshëm fshatrash të cilët nuk furnizohen me ujë nëpërmjet sistemit të ndërmarrjes UKL, për këtë arsye familjet që janë jashtë kësaj skeme i plagojnë detyrimet e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në sportelet e Postes Shqiptare ose në sportelet e bankave të nivelit të dyte pasi kanë marrë faturën në sportelin e Zyrës me 1 Ndalese (Z1N).

Masat shtrënguese janë të parashikuara në Paketën Fiskale të bashkisë, por masat nxitëse në tërësi mungojnë. Gjithashtu, shpesh familjet janë të përjashtuara edhe nga masat shtrënguese. Tarifa e shërbimit për familjet është **3000 leke/vit/familje** në zonën e pare të shërbimit dhe **1800 lekë/vit/familje** në zonën e dyte dhe të treta të shërbimit. Vlen për tu përmendur fakti se në tarifën e sipërpërmendur përfshihen edhe shërbime të tjera si: pastrimi, ndriçimi, dekori dhe gjelbërimi. Ky është një fenomen që haset në shumë bashki, por bashkia e Lezhës po diskuton nevojën që të marrë në konsideratë ndarjen e kostove dhe tarifave për çdo shërbim të vecantë, pasi një gjë e tillë kërkohet edhe në kuadër për hartimit të buxhetit sipas programeve, ku ndërsa pastrim gjelberim etj. janë pjesë e një programi tjetër, (shërbimet publike), ndërsa menaxhimi i mbetjeve konsiderohet në një program tjetër (mbrojtja e mjedisit). Sidoqoftë, për përlllogaritjen e buxhetimit sipas programeve përkatëse, tarifa për menaxhimin e mbetjeve urbane, është e llogaritur në masën 62% të tarifës së shërbimeve publike.

Tarifa e shërbimit për bizneset e vogla varion nga **1.000 leke/vit/biznes** deri ne **30.000 leke/vit/biznes** për bizneset e vogla dhe te mesme dhe nga **27.000 leke/vit/biznes** deri ne **250.000 leke/vit/biznes** për bizneset e mëdha prodhuese.

Tarifa e shërbimit për institucionet mesatarisht është **100 leke/m2/vit**.

7.2.1 Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave

Të ardhurat e planifikuara të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Lezhë përfshijnë mbledhjen e tarifës nga familjet, institucionet dhe bizneset tek të cilët faturohet shërbim. Tabela e mëposhtme paraqet te ardhurat dhe shpenzimet ne vitin 2020.

Zerat e te ardhurave	2020
Te ardhurat nga Menaxhimi i Mbetjeve	43,048,960.96
Te ardhurat nga Burimet e Veta	n/a
Shpenzimet për shërbimin e MMN	78,416,000
Përqindja e mbulimit të koston nga tarifa	54.9 %

Tabela 10: Te ardhurat dhe shpenzimet ne vitin 2020

Niveli i mbulimit të kostove të shërbimit me të ardhurat e tij, i paraqitur në tabelen e mësipërme, është i ulët; të ardhurat e realizuara mbulojnë rreth 54.9% të koston së shërbimit.

Veçanërisht, nisur nga kosto vjetore për banor e shërbimit prej 984 lekësh, mund të përafrojmë koston vjetore të tij për familje, me madhësi mesatare të saj, sipas të dhënave të popullsisë të Gjendjes Civile, prej rreth 4 pjesëtarësh. Kështu, kosto vjetore për familje e shërbimit përlllogaritet 3936.35 lekë, dhe është 936 lekë më e lartë se tarifa maksimale vjetore për familje prej 3000 lekësh. Megjithatë duke marre parasysh faktin qe tarifa/taksa te tjera janë te përfshira ne faturën e shërbimit te menaxhimit te mbetjeve e hap akoma dhe me tepër boshllëkun ekonomik per vetëfinancimin e shërbimit.

Mospërputhja e këtyre dy komponentëve financiarë të shërbimit ndeshet në përgjithësi në financat vendore në Shqipëri, dhe pra *niveli i tarifës së shërbimit disa herë më i ulët se kosto për njësi e tij* është një rezultat i pritshëm. Mos mbulimi i koston ne Bashkinë tone vjen edhe si rrjedhoje e koston se larte te shërbimit per banore ne njësite administrative ku shpërndarja gjeografike e popullsisë është tepër e larte dhe kostoja e ofrimit te shërbimit është e larte për te ardhurat qe familjet kane.

Per vitin 2020 kemi keto te dhena per planin e te ardhurave prej tarifes se pastrimit per kategorie e perfitueseve si familjet, bizneset dhe institucionet.

Nr.	Emertimi	Plani (000 leke)	Fakti (000 leke)	%
	Tarifa e pastrimit	66271.8	44252	66.8%

Tabela 11: Realizimi i te ardhurave prej tarifës se pastrimit për vitin 2020

7.3 Financimi i shërbimit

Burimi vjetor i fondit për shpenzime operative vjen kryesisht nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhura të tjera pa destinacion, përkatësisht 25%, ndërsa të ardhura të veta përbëjnë 75% të burimit të financimit për këtë shërbim. Për menaxhimin e mbetjeve përdoren të ardhurat e zërit përkatës.

% e financimit të shërbimit nga të ardhurat e tarifës se shërbimit per menaxhimin e mbetjeve	52.2%
% financimit të shërbimit nga transfertat e pakushtëzuar	47.8%


Tabela 12: Kosto për njësi e realizimit të shërbimit.

	2017	2018	2019	2020
Të ardhurat e realizuara të shërbimit (lekë/vit)	30,608	50,174	47,766	44,252
Shpenzimet e realizuara të shërbimit (lekë/vit)	67,022	67,022	68,274	84,802
% e mbulimit të kostos nga të ardhurat nga tarifa	45.7	74.9	70.0	52.2

Tabela 13: Pasqyrimi i raportit kosto - të ardhura

Sic shihet dhe në tabelën e mësipërme për mbulimin e kostos së ofrimit të shërbimit mbulohet në nivelin 70% të kostos totale të shërbimit (2019), i cili mund të jetë edhe më i ulët për shkak të pamundësisë së përcaktimit të nivelit të të ardhurave vetëm për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve duke patur parasysh që në faturën e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve paguhen edhe tarifa/taksa për shërbime të tjera si: gjelberimi, pastrimi, dekorimi dhe ndricimi.

Nga ana tjetër duke bërë një krahasim me vitet pararendëse ka një ngritje të ndjeshme të nivelit të mbulimit të kostove nga të ardhurat nga tarifa e shërbimit si rezultat i integritetit të pagesës së faturës së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në faturën e pagesës së shërbimit të ujit dhe kanalizimeve.



Grafiku 5: Grafiku i pasqyrimet te mbulimit te kostove nga te ardhurat

Nga tabela me sipër dhe ky grafik kuptojme se në vitin 2018, 75% e koston totale te shërbimit mbulohehet nga te ardhurat prej tarifës se shërbimit qe ne krahasim me vitin 2017 eshte nje hap i rëndësishem perpara ne aspektin e financimit te shërbimit; ndersa 25 % e koston se mbetur mbulohehet nga buxheti i bashkise ose pjese nga transferta e pakushtezuar. Ky trend është ruajtur edhe gjatë vitit 2019 (70%), ndërsa në vitin 2020, ka patur anomali qoftë në reduktimin dhe mbledhjen e tarifave, ashtu edhe në shtrirjen me projektin pilot të mbledhjes derë më derë që ka rritur koston, prandaj ka një lëvizje të madhe në përqindjen e mbulimit të koston.

Në menyre të dukshme ndërsa bashkia mund të konsiderojë rritjen e tarifës, gjithsesi me rrezerve, duhet të përmirësojë efektivitetin dhe eficiencen e faturimit dhe të arketimit të të ardhurave nga tarifa e shërbimit, vecanërisht në kategorinë familjare.

Treguesi F2: Efienca në grumbullimin e tarifave

Ky tregues mat shkallën e grumbullimit të të ardhurave të gjeneruara nga përfituesit e shërbimit në raport me të ardhurat e parashikuara për t’u grumbulluar. Në analizë kemi marrë treguesit e vitit 2019, duke qenë se ende nuk i kemi të gjitha rezultatet përfundimtare të vitit 2020, por edhe për faktin se duke qenë viti 2020 një vit i karakterizuar nga ndikimi i tërmetit të nëntorit 2019 si dhe të pandemisë Codiv-19, Këshilli Bashkiak ka vendosur për një ulje të taksave prej 30% për të gjitha kategoritë, duke e kthyer në një vit anomal për përlogaritjen e trendeve të mbulimit të koston nga tarifat përkatëse.




Figura 14: Rezultatet e treguesit – Grumbullimi i tarifës së shërbimit për bashkinë Lezhë

Bashkia Lezhë ka një nivel mesatar (pak mbi nivelin e ulët) të grumbullimit të tarifës së pastrimit. Në vitin 2016 ky nivel shtrihet në intervalin nga 33% (në zonën e tretë të shërbimit) deri në 56% (zona e parë e shërbimit) me një mesatare prej 45.5% për të gjithë bashkinë. Me këtë nivel të grumbullimit të tarifës, bashkia është në një zonë të rrezikshme përse i përket qëndrueshmërisë financiare.

Në vitin 2019 bashkia arrin të grumbullojë rreth 80% të tarifave nga përfituesit e shërbimit, duke u pozicionuar në zonën e gjelbërt ose në zonën ku grumbullimi i tarifave konsiderohet i lartë.

Gjithësesi, ashtu si edhe për komponentin e mësipërm (mbulimin e kostos), përsëri ne nuk mund të gjykojmë mbi trendin e këtij treguesi për çdo zonë me vetë, pasi bashkia nuk ka të dhënat e nevojshme për të llogaritur këtë tregues për çdo zonë.

Rekomandimi jonë për bashkinë është që në të ardhmen të këtë mundësi të organizojë database-in e saj sipas tabelës së mëposhtme:

	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Totali
Të ardhurat e parashikuara për familjet familjet				21,432,000
Të ardhurat e grumbulluara nga familjet				14,206,000
Norma e grumbullimit për kategorinë familje				66.3%
Të ardhurat e parashikuara për biznesin e vogël				16,387,000
Të ardhurat e mbledhura nga biznesi i vogël				14,055,000
Norma e grumbullimit për kategorinë biznes i vogël				85.8%
Të ardhurat e parashikuara për biznesin e madh				26,737,000
Të ardhurat e mbledhura nga biznesi i madh				24,987,000
Norma e grumbullimit për kategorinë biznes i madh				93.5%
Të ardhurat e parashikuara nga institucionet				2,603,000
Të ardhurat e mbledhura nga institucionet				273,000
Norma e grumbullimit për kategorinë institucione				10.5%
Norma e grumbullimit për bashkinë				79.7%

Nëse bashkia do jetë në gjendje të gjenerojë këto të dhëna, atëhere për çdo zonë shërbimi, për çdo kategori përfituesi shërbimi mund të jepen rekomandime konkretë sesi të merren masa korrektuese për të rritur në të ardhmen këtë tregues, i cili është edhe treguesi më i rëndësishëm i qëndrueshmërisë financiare.

Gjithësesi, me të dhënat që kemi në dispozicion për çdo kategori në rang bashkie (jo në nivel zone shërbimi) ne mund të bëjmë krahasimin e progresit që ka pasur bashkia Lezhë ndër vite në drejtim të grumbullimit të tarifës për çdo kategori.




Figura 15: Kontributi i çdo kategorie përfituese e shërbimit në grumbullimin e tarifës për bashkinë Lezhë

Nga figura e mësipërme, duket qartë që bashkia Lezhë në përgjithësi ka bërë një progres që nga hartimi i planit lokal për menaxhimin e mbetjeve në vitin 2016. Përqindja e grumbullimit të tarifave për kategorinë familje është rritur me gati 3 herë ndërsa për kategorinë biznese është rritur me 23%. Për kategorinë institucione kemi një rënie në grumbullimin e tarifës nga 15 në 11%. Në total për bashkinë Lezhë në vitin 2019 grumbullimi i tarifës ka pësuar një rritje me 73% krahasuar me 2016.

8. Komunikimi me qytetarët, ndërgjegjësimi dhe edukimi

Në Bashkinë Lezhë nuk ka një sistem të marrëdhënieve me qytetarët, përmes të cilit të priten kërkesa ose ankesa prej tyre dhe jepen përgjigje. Ky shërbim gjithashtu ofrohet në ZIN, pranë bashkisë në të cilën banoret mund të paraqesin ankesat e tyre të cilat me pas adresohen pranë drejtorisë së shërbimeve. Koha mesatare e përgjigjes së kërkesës/ankesës është 24 ore.

Tipi i të dhënave	Vlera
Numri i ankesë/kërkesa të ngritura nga qytetarët/bizneset (viti 2020)	50
Numri i përgjigje/zgjidhje të ofruara nga bashkia? (viti 2020)	50

Tabela 14: Të dhëna mbi ankesë/kërkesa

Veprimtaritë e ndërgjegjësitimit janë të shpeshta në bashkinë Lezhë. Mjete komunikimi si mediat apo faqet zyrtare në rrjetet sociale vendore përdoren në Bashkinë Lezhë lidhur me rëndësinë e menaxhimit të mbetjeve. Kjo çështje kërkon vëmendje dhe mbështetje ndaj bashkisë në mënyrë që të përmirësojë mbledhjen dhe adresimin e ankesë/kërkesa të qytetarëve si dhe zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuere dhe edukuese në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

Tipi i të dhënave	Vlera
A zhvillon bashkia aktivitete apo evente informuese/ndërgjegjësuere për menaxhimin e integruar të mbetjeve? (PO/JO)	Po
A zhvillojnë organizatat private/publike aktivitete apo evente informuese/ ndërgjegjësuere për menaxhimin e integruar të mbetjeve? (PO/JO)	Po
Mesatarja e aktiviteteve/eventeve në vit?	13

Tabela 15: Të dhëna mbi aktivitetet ndërgjegjësuere dhe edukuese

9. Gjendja Mjedisore

Pavarësisht se shërbimi ofrohet pothuajse në të gjithë territorin e bashkisë Lezhë, ndodhen hapësira në të cilën janë depozituar mbetje të ndryshme të cilat kanë nevojë të levizën dhe të depozitohen në landfillin e Bushatit. Me qëllim planifikimin e ndërhyrjes për rehabilitimin e këtyre vendeve të depozitimit, është i nevojshëm një përcaktim më i saktë i tyre, duke dalluar ndërmjet atyre që janë vend-depozitime mbetjesh të përdorura vazhdimisht nga një fshat, qytet apo disa fshatra e qytete së bashku, dhe atyre që janë pika grumbullimi mbetjesh të përdorura vazhdimisht nga një grup banorësh në mungesë të kontejnerëve, ose të krijuar nga depozitime pa kriter të mbetjeve nga banorët, të cilat janë rastësore ose jo të vazhdueshme.

Si tregues për të përcaktuar këto dy forma vend-depozitimesh të egra është sugjeruar vëllimi i mbetjeve që ato përmbajnë dhe lloji i tyre, meqenëse të dhënat nuk përfaqësojnë mbetje të rrezikshme në këto vend-depozitime por vetëm mbetje ngurta urbane dhe inerte, përcaktues do të jetë vetëm treguesi i vëllimit, ku pragu të jetë vëllimi 20 m³ mbetje, kështu, vend-depozitimet që përmbajnë

20 m³ mbetje e më shumë do të përcaktohen si ‘vend-depozitime të egra’ ndërsa ato që përmbajnë më pak se 20 m³, si ‘pika grumbullimi të hapura’.

Pasojat e vend-depozitimeve të mësipërme në ujërat, tokën apo ajrin në zonë kërkojnë një vlerësim të posaçëm, ndërkohë, nga inspektimi në terren, shkalla e rrezikshmërisë së tyre ndaj mjedisit, në një përshkallëzim: e lartë, mesatare dhe e ulët, vlerësohet mesatare.

I vetmi vend-depozitim që referohet për rehabilitim është ai në Lagjen Nënë Tereza i cili parashikohet për një përdorim 3-5 vjeçar. Në Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, Bashkia Lezhë 2017-2021, venddepozitimi në Lagjen Nënë Tereza shfaqet si një nga pikat kryesore dhe problematike të grumbullimit të mbetjeve inerte.

10. Përmbledhje e gjetjeve kryesore të gjendjes fillestare

Burimet njerëzore dhe mjetet

Në Bashkinë Lezhë burimet njerëzore për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve janë të shpërndara ndërmjet veprimtarisë së *mbledhjes* - punëtorët, *transportit* – shoferët (pjesë e ekipit të operatorëve që ofrojnë shërbimit) dhe *administrimit* - drejtori i shërbimeve publike si dhe sektori i mbikqyrjes së shërbimeve publike, pjesë e administratës së bashkisë. Gjithashtu prania dhe angazhimi i administratorëve të njësive administrative e përmirëson gatishmërinë dhe përgjegjshmërinë ndaj ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.

Bashkia Lezhë ka në përdorim kontejnerë plastik, me vëllim 1.1 m³, të vendosur në pika të përcaktuara nga bashkia për grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane, kryesisht me nga dy dhe tre kontejner për një pikë grumbullimi, gjithsej janë 960 kontenierë, pronë e operatorëve.

Duke ju referuar numrit të kontejnerëve të shpërndarë, kemi një mesatare prej 1 kontejner për 83 banorë i cili është një numër i madh kontenierësh, normë e cila do të korrigjohet në planin e rishikuar, duke optimizuar itineraret e mbledhjes dhe të vendosjes së koshave, në mënyrë që të reduktohet kostoja e shërbimit.

Vihet re se operatorët nuk kanë respektuar standardet e vendosjes sipas qellimit dhe kodit të ngjyrave dhe sinjalisitiken udhëzuese të kontejnerëve. Një prej problematikave që qëndron me kontenierët e shpërndarë në territorin e bashkisë Lezhë janë erërat e forta të cilat i lëvizin kontenierët, të cilat kanë qenë me material plastik, sidomos gjatë kohës që janë të zbratur, dhe i përplasnin ato me automjetet e parkuara përgjatë rrugës ose rrezohen në asfalt duke i dëmtuar.

Mjetet e ofrimit të shërbimit (kamionët) janë në pronësi të operatorëve të cilët ofrojnë shërbimin në tre zonat e shërbimit. Në bashku ato kanë në pronësi 7 kamionë teknologjikë për kryerjen e

shërbimit të mbledhjes dhe transportit të mbetjeve urbane të cilët janë relativisht të rinj (prodhimi pas vitit 2010).

Gjendja e shërbimit.

Shërbimi i mbledhjes dhe transportit të mbetjeve në Bashkinë Lezhë aktualisht ofrohet pothuaj për të gjithë popullsinë. Sipas mbetjeve të mbledhura dhe numrit të përafëruar të banorëve të shërbyer llogarisim një gjenerim mesatar të përafërt prej 0.5 kg/banor/vit, me mundësinë për të diferencuar ndërmjet një gjenerimi të zonave urbane prej 0,7 kg/banor/dite dhe zonës rurale prej 0,4 kg/banor/dite, por që deri më sot, si për shkak të mungesës së kulturës së diferencimit të mbetjeve në burim, ashtu edhe për një sërë faktorësh të tjerë nuk ka qenë e mundur të realizohet.

Shërbimi kryhet në një frekuencë e cila varion në 3 - 7 herë/javë zonën e parë të shërbimit (me frekuencë 14 herë në javë gjatë sezonit turistik) e përbërë nga qyteti i Lezhës dhe Shëngjinit dhe 2 - 3 herë/javë në njësitë e tjera administrative (me frekuencë 7 herë në javë në zonën turistike të Talës pjesë e zonës 2 të shërbimit).

Në tërësi, dezinfektimi i kontejnerëve dhe pikave të grumbullimit kryhet rregullisht dhe ka një grafik pune. Kontejnerët grumbullohen nga operatorët në pikat e tyre të grumbullimit.

Gjendja Financiare

Në bashkinë e Lezhës kosto gjithsej e këtij shërbimi është e përbërë, nga zëri i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore të punonjësve 16%, nga zëri shpenzime të tjera për materiale pune dhe të tjera për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve 1%, dhe nga zëri i menaxhimit të mbetjeve 83% i cili është i kontraktuar në 3 operatore të cilët operojnë në 3 zona shërbimi. Bashkia ka një bazë të dhënash për të gjithë klientët që marrin shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Aktualisht kjo bazë të dhënash është e ndarë midis dy bazave të dhënash, e parë është baza e të dhënave të ndërmarrjes Ujësjellës-Kanalizime Lezhë dhe e dyta sipas bazës së të dhënave të zyrës së gjendjes civile.

Gjatë vitit 2019 janë faturuar vetëm 15.732 familje me vlerë 9.000.000 leke. Ndërsa janë faturuar 100% e institucioneve dhe bizneseve të regjistruara në bashki. Niveli i mbulimit të kostove të shërbimit me të ardhurat është mesatar; të ardhurat e realizuara mbulojnë rreth 75% të kostos së shërbimit. Megjithatë kjo përqindje mund të jete më e ulët për shkak të shërbimeve të tjera të cilat paguhet në të njëjtën faturë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

Burimi vjetor i fondit për shpenzime vjen dhe nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhura të tjera pa destinacion, përkatësisht 25%, ndërsa të ardhura të veta përbëjnë 75% të burimit të financimit për këtë shërbim. Të ardhurat nga burimet e veta të përdorura për Menaxhimin e Mbetjeve vijnë nga të ardhurat e të njëjtit zë.

Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve

Bashkia depoziton të gjitha mbetjet në landfillin e Bushatit. Cdo mjet i cili përfundon shërbimin e grumbullimit drejtohet dhe i dërgon mbetjet në landfill i cili ndodhet rreth 25 km nga qendra e bashkisë Lezhe. Bashkia është pjesë e skemës rajonale Shkodër – Lezhë, e cila ka të parashikuar si pike fundore për depozitim dhe trajtimin e mbetjeve këtu landfill. Depozitimi në landfill kryehet nga operatorët, sipas specifikimeve të kontratave respektive.

I vetmi vend-depozitim që ka probleme për risistemimin e tij, është ai në Lagjen Nënë Tereza, i cili parashikohet për një përdorim 3-5 vjeçar për mbetjet inerte. Në Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, Bashkia Lezhë 2017-2021, venddepozitimi në Lagjen Nënë Tereza shfaqet si një nga pikat kryesore dhe problematike të grumbullimit gjatë sezonit turistik.

11. Identifikimi i ndryshimeve dhe përmirësimeve të mundëshme

Ky paragraf ka për qëllim që të pasqyrojë ndryshimet, përmirësimet apo politika të reja që bashkia do dhe mendon se mund të realizojë në kuadër të rishikimit të planit.

Keto ndryshime apo përmirësime rrjedhin nga problematikat e identifikuara gjatë fazës së analizës bazë si dhe nga diskutimet me drejtues të bashkisë dhe grupet e interesit.

Për të ngritur standardin dhe për të përmirësuar shërbimin është e nevojshme që:

1. Megjithë numrin e madh të kontejnerëve në sistem, vihet re se është e nevojshme që të rishikohet në respekt të planit operacional si vendosja e pikave të grumbullimit ashtu dhe e kontejnerëve;
2. Specifikë për Lezhën, e papaprishikuar në plan, është era e fortë për një pjesë të konsiderueshme të vitit e cila bën që kontejnerët plastik të lëvizin dhe pikat e grumbullimit të jenë të paqëndrueshme, për rrjedhojë pikat e grumbullimit dhe kontejnerët duhet të vendosen në mënyrë të tillë dhe të pajisen me mbajtëse që të mos lëvizin nga era. Rekomandohet që të ndryshohen edhe kontejnerët nga plastikë në kontejnerë metalikë, sidomos për zonën 1.
3. Sipas mbetjeve të mbledhura dhe numrit të përafëruar të banorëve të shërbyer llogarisim një gjenerim mesatar të përafërt prej 0.5 kg/banor/vit, me mundësinë për të diferencuar ndërmjet një gjenerimi të zonave urbane prej 0,7 kg/banor/dite, zona trustike me 1 kg/banor/ditë dhe zonës rurale prej 0,4 kg/banor/dite. Në respekt të kësaj llogaritje, zona 2 e shërbimit që është miks rurale, periurbane dhe turistike, kemi marrë për bazë llogaritje normën e gjenerimit prej 0.5 kg/banor/ditë. Në kuadër të hartimit të këtij plani bashkia Lezhe, në bashkëpunim me EcoDes Studio, ka bërë një analizë të sasisë dhe përbërjes së mbetjeve si në landfill ashtu dhe me anketim. Kjo i ka ofruar bashkisë një informacion shumë të qartë vecanërisht për përbërjen e mbetjeve dhe për rrjedhojë përjasje me të saktë për të hartuar dhe adoptuar skema funksionale të evadimit të mbetjeve, si dhe projeksione

të mundshme për hartimin e politikave për të aplikuar ndarjen në burim për riciklim dhe kompostim.

4. Në politikat e reja në kuadër të zbatimit të këtij plani Bashkia Lezhë do të mendojë për skema që të fillojë aplikimin e kompostimit në shtëpi vecanërisht në zonat peri-urbane por edhe rurale me turizëm të zhvilluar.
5. Bashkia ka një bazë të dhënash për të gjithë klientët që marrin shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Aktualisht kjo baza të dhënash është e ndare midis dy baza të dhënash, e pare është baza e të dhënave të ndërmarrjes Ujësjellës-Kanalizime Lezhë dhe e dyta sipas bazës së të dhënave të zyrës së gjendjes civile. Në këtë kuadër bashkia do të unifikojë një bazë të dhënash mbi bazën e të cilës të gjenerojë një faturë për të gjithë klientët të cilët marrin shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve. Kjo do të rrisë përqindjen e faturimit dhe për rrjedhojë të ardhurat nga tarifa
6. Në këtë plan bashkia ka adresuar gjithashtu edhe çështjet si vijojnë:
 - a. Përcaktimi i tarifës veçmas shërbimeve të tjera si, pastrimi, gjelberimi, ndriçimi, dekori etj.;
 - b. Shtrirja e shërbimit në zonën e mbetur (Ungrej),
 - c. Përmirësimi i komunikimit me qytetarët dhe bizneset si dhe planifikimi dhe ekzekutimi i një Plani Komunikimi dhe Ndërgjegjësimi i cili do të sigurojë vazhdueshmëri dhe gjithpërfshirje.
 - d. Vendosja e kontrollit në vend-depozitimet e pakontrolluara dhe adresimi i problematikës së vend-depozitimeve të egra.

11.1 Vlerësimi i zonave për zgjerimin e shërbimit dhe përfshirja e praktikave të reja për reduktimin e mbetjeve

- a. Bashkia Lezhë ka një mbulim shumë të mirë me shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve të ngurta bashkiake. Jashtë zonës së mbulimit gjatë periudhës 2017-2021, kishte mbetur Njësia Administrative Ungrej për shkak të terrenit dhe të aksesit rrugor. Edhe pse ka patur përpjekje për të mbuluar këtë zonë me shërbim, kjo praktikë ka dështuar. Në këtë plan është imperative shtrirja e shërbimit në këtë njësi, si një sfidë për bashkinë edhe në kuadër të zbatimit të objektivave të planit të rishikuar, duke qenë se edhe infrastruktura rrugore ka nisur të përmirësohet.
- b. Për shkak të zhvillimit intensiv të turizmit vecanërisht në NJA Shëngjin por edhe në njësi të tjera, bashkia ka shikuar me prioritet rregullimin e dhënies së shërbimit në këto zona. Në këtë kontekst është rishikuar itinerari i mbulimit me shërbim i zonës së Shëngjinit përgjatë rrugës kryesore të qytetit, shëtitores, Ranës së Hedhun, Kune-Sakë dhe të gjithë hapsirës së zhvilluar gjatë viteve të zbatimit të planit. Në këtë kuadër është zgjeruar edhe diapazoni kohor i ofrimit të shërbimit të zgjeruar nga 90 ditë në 150 ditë (maj-tetor).
- c. Rregulla të forta të shoqeruara me gjopa të cilat duhet të vendosen në rregulloren e shërbimit por edhe në paketën fiskale të çdo viti buxhetor, duhet të aplikohen për nxjerrjen

e mbetjeve nga gjeneruesit në sistemin e kontejnerëve, vecanërisht të zbatueshme gjatë periudhës së pikut të gjenerimit të mbejeve në periudhën turistike.

- d. Në zonat turistike (Shengjin etj) nuk duhet të ketë frekuencë të grumbullimit të mbetjeve më të lartë se dy herë në ditë (në darkë dhe/ose herët në mëngjes). Kjo do të realizohet nga zbatimi i fortë i rregullit që vecanërisht bizneset nuk mund ti nxjerrin mbetjet në sistem vecse kur të përfundojnë aktivitetin e tyre në mbrëmje vonë ose në mëngjes herët përpara se të ketë filluar grumbullimi i tyre.
- e. Bashkia, në vitet në vijim, në varësi të ecurisë së shërbimit dhe mundësive praktike financiare, do të rivlerësojë nëse ideja e hedhur në planin aktual për ndërtimin e një qendre per reduktimin e mbetjeve është akoma i mundur. Nëse jo, atëherë bashkia duhet të fokusohet në metoda më të thjeshta sic janë përshkruar më poshtë.
- f. Nga ana tjetër reduktimi i mbetjeve të biodegradueshme nëpërmjet kompostimit të plotë të mbetjeve në shtëpi me kontejnerë kompostimi është një praktikë e cila po përhapet me sukses në shumë vende të rajonit përfshi dhe Kosovën, dhe për këtë arsye edhe Bashkia Lezhë do të vlerësojë mundësinë për nxitjen e kompostimit të mbetjeve, sidomos në zonat rurale më rëndësi turistike, si psh, Fishta apo Tale.
- g. Gjatë periudhës së pikut turistik, bizneset e shërbimit mund të pajisen me kosha specifik prej teli për të mundësuar ndarjen në burim të mbetjeve të riciklueshme, si një mundësi reale për reduktimin e mbetjeve që shkojnë në landfill.

Në mënyrë specifike bashkia e Lezhës duhet të rregullojë mbulimin me shërbim të zonës turistike në brezin Shënkoll – Shëngjin deri në veri në vendin e quajtur Rana e Hedhun. Harta me poshtë specifikon zonat e zgjerimit, rregullimit të shërbimit.

Zgjerimi apo rregullimi i shërbimit do të presupozojë:

1. shtrirjen, zgjerimin e zonës së shërbimit;
2. rirregullimin e vendosjes së pikave të grumbullimit të mbetjeve,
3. forcimin e rregullores dhe percaktimin e rregullave specifike për nxjerrjen e mbeturinave në sistem nga gjeneruesit e tyre.
4. Fakti që Bashkia do të zëvendësojë kontejnerët 11 m³ me kosha rrogorë në shëtitoren e plazhit të Shëngjinit, kërkon një rishikimi të shpërndarje së kontejnerëve në zonën e qytetit.




Figura 6: Përcaktimi i zonave për zgjerimin dhe rregullimin e shërbimit

11.2 Rishikimi i projeksioneve për popullsinë dhe sasinë e mbetjeve

Projeksioni i popullsisë dhe sasisë së mbetjeve është bazuar mbi supozimet si ne tabelën që vijon:

Te thenat baze viti 2019			
Nr. Ref	Karakteristikat e grumbullimit		
1	Kontenieret e pershtatshem		
2	Konteniere 1.1 per banoret ne zonen e qytetit	1.1	m3
3	Konteniere 1.1 per banoret ne zonen rurale	1.1	m3
4	Konteniere 1.1 per bizneset	1.1	m3
	Makinat e pershtatshme		
5	Makine 18 m3 per zonen e qytetit me apartament	15	m3
6	Makine 18 m3 per zonen e qytetit me banesa individuale	15	m3
7	Makine 16 m3 per zonen rurale	12	m3
8	Makine 16 m3 per bizneset	12	m3
	Frekuenca e sherbimit per banore dhe biznese		
9	14 here ne jave per zonen e qytetit me apartamente	2	here ne dite
10	7 here ne jave per zonen e qytetit me banesa individuale	1	here ne dite
11	2 here ne jave per zonen rurale	0.29	here ne dite
12	7 here ne jave per bizneset ne te dyja zonat	1	here ne dite
	Te dhena demografike		
13	Nr. Banoreve ne zonene e perzgjedhur	79,648	
14	Nr. Banoreve ne zone urbane	29,788	
15	Nr. Banoreve ne zonen turistike	35,000	
16	Nr. Banoreve ne zonen rurale	49,860	
	Familje qe jetojne ne zonen e e perzgjedhur	21,717	3.6 banore/familje
17	Familje qe jetojne ne zonen e qytetit ne apartament	8,511	3.5 Banore/familje
18	Familje qe jetojne zonen e qytetit ne banesa individuale	2,715	3.5 Banore/familje
19	Familje qe jetojne ne zonen rurale	11,080	4.5 Banore/familje
20	Bisnese te medha	582	
21	Bisnees I vogel	2003	
	Te dhena te gjenerimit		
22	Per familjet qe jetojne ne zone urbane	256	kg/person/vit
23	Per familjet qe jetojne ne zone turistike	73	kg/person/vit
24	Per familjet qe jetojne ne zonen rurale	146	kg/ person/vit
26	Densiteti I mbetjeve	0.26	t/m3
	Supozime		
27	Koeficienti I mbushjes se kontenjerit	75%	
28	Koeficienti I ngjeshjes se makines teknologjike	3	
29	Numri I punetoreve per makine	3	1 shofer + 2 puntore
30	Ditet e puneve ne vit	300	

Te thenat baze viti 2019			
Nr. Ref	Karakteristikat e grumbullimit		
Te dhena statistikore			
31	% rritjes se popullise	0.3%	Skenari larte i rritjes se popullise
32	% e rritjes se nr. Bizneseve	0.15%	supozim
33	% e rritjes se gjenerimit per banor	0.60%	supozim

Tabela 16: Të dhënat bazë për projeksionin e popullsisë dhe të sasisë së mbetjeve

Per projeksionet disa rregulla duhet te zbatohen:

1. Lloji i konteniereve ne kete seksion perkon me kontenieret qe aktualisht jane ne perdorim per ofrimin e sherbimit (psh vija e bregdetit të Tales parashikohet të sherbehet dere me dere me konteniere 120 L).
2. Lloji i makines ne kete seksion perkon me makinat qe aktualisht jane ne perdorim per ofrimin e sherbimit.
3. Frekuenca e sherbimit mund te modifikohet sipas frekuencave te zgjedhura nga ana e grupeve te punes per secilen prej zonave te sherbimit (Zona 1 (urbane), Zona 2 (periurbane), Zona 3 (rurale) etj.).
4. Nr. Total i popullise llogarit personat qe jetojne ne bashki ose ne zonen qe do te marre sherbim.
5. Ne seksionin “Te dhena demografike” ndarja e kategorive është bërë sipas zonave te sherbimit qe ka aktualisht bashkia, pra ndarja në tre zona sipas këtij plani.
6. Ne te njejten menyre si ne kategorine e te dhenave demografike llogaritet edhe gjenerimi i mbetjeve, pë secilën zonë shërbimi.
7. Projeksioni i popullise eshte bazuar mbi parashikimin e rritjes se popullise sipas Skenarit te Rritjes se Larte, INSTAT.
8. % e rritjes se numrit te bizneseve dhe te sasise se mbetjeve jane supozime per efekt demonstrimi. Keto te dhena janë marrë nga zyra e tatim taksave dhe zyra e gjendjes civile ne rastin e rritjes se numrit te popullise.

11.3 Projektionet bazë të popullsisë, sasisë së mbetjeve dhe mjeteve

Projeksioni i popullsisë:

	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Lezhë	20,285	20894	21520	22166	22831	23516
Shëngjin	9,503	9788	10082	10384	10696	11017
Balldren	7,582	7809	8044	8285	8534	8790
Blinisht	4,084	4207	4333	4463	4597	4734
Dajç	4,854	5000	5150	5304	5463	5627
Kallmet	5,083	5235	5393	5554	5721	5893
Kolsh	5,140	5294	5453	5617	5785	5959
Shënkoll	14,263	14691	15132	15586	16053	16535
Ungrej	1,985	2045	2106	2169	2234	2301
Zejmen	6,869	7075	7287	7506	7731	7963
Totali	79,648	82,037	84,499	87,034	89,645	92,334


Projeksioni I gjenerimit të mbetjeve ton/vit:

Projeksioni I gjenerimit (t/v)							
	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Zone urbane	7,718	7,741	7,764	7,787	7,811	7,834	7,858
Zone turistike	702	704	706	708	711	713	715
Zone rurale	7,367	7,389	7,412	7,434	7,456	7,478	7,501
Totali	17,807	17,855	17,904	17,952	18,001	18,050	18,099

Projeksioni i gjenerimit të mbetjeve ton/ditë:


Projeksioni I gjenerimit (t/d)							
	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Zone urbane	21.1	21.2	21.3	21.3	21.4	21.5	21.5
Zona turistike	2	2	2	2	2	2.0	2.0
Zone rurale	20.2	20.2	20.3	20.4	20.4	20.5	20.6
Totali	43.3	43.4	43.5	43.6	43.8	43.9	44.0

Objektivat e grumbullimit të mbetjeve (%/vit)



Grafiku 6: Paraqitja grafike e objektivave për grumbullimin e mbetjeve në harkun kohor të planit

Shenim: Zona Urbane dhe Zona Turistike janë në të njëjtin nivel shërbimi.



Grafiku 7: Paraqitja e projeksionit te sasise se mbetjeve te grumbulluara

12. Qëllimi, objektivat dhe rezultatet

Qëllimi dhe parimet e bashkisë Lezhë për menaxhimin e mbetjeve burojnë nga legjislacioni në fuqi dhe ambicia e Shqipërisë për tu afruar me standardet evropiane në përputhje me Direktivat respektive të BE në këtë fushë.

Objekti i këtij plani janë mbetjet e ngurta bashkiake, të cilat përgjithësisht përcaktohen si mbeturina shtëpiake, mbeturina të ngurta të parrezikshme të aktivitetit tregtar, institucioneve, tregjeve, mbeturina nga oborret dhe nga fshirja e rrugëve. Menaxhimi i Mbetjeve përmbledh aktivitetet grumbullimin, transportin, depozitimin dhe trajtimin e tyre.

Qëllimi universal i PMIM i bashkisë Lezhë, do të përmbledhet si në vijim:

“Bashkia Lezhë ka si qëllim të realizojë një shërbim efektiv dhe eficient, për të gjithë banorët dhe ta shtrirë në të gjithë territorin me një standard të përballueshëm prej qytetarëve në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e mjedisit dhe të mbrojë shëndetin e qytetarëve duke garantuar cilësi më të mirë për jetën dhe aktivitetin e banorëve, të mbështesë një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, me fokus në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, duke përmbushur kriteret për të ndihmuar rrugën drejt integritimit evropian të vendit.”

12.1 Objektivat e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve në Bashkinë Lezhë

Objektivat e bashkisë Lezhë për menaxhimin e mbetjeve bazohen mbi objektivin kombëtar siç janë specifikuar nga VKM Nr. 418, datë 25.06.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, si dhe të VKM 608, datë 17/09/2014, të cilët në mënyrë të përmbledhur shprehen respektivisht:

Synimi kryesor i bashkisë Lezhë në këtë plan është përmbushja e standarteve për menaxhimin e mbetjeve duke përmbushur parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit, duke mbuluar me shërbim të gjithë territorin e aksesueshëm dhe duke zgjeruar shërbimin për zonën me frekuentim të lartë turistik, duke përmirësuar situatën e financimit të shërbimit, dhe duke rritur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e komunitetit në këtë proces.

Në këtë kontekst, objektivat e PMIM për bashkinë Lezhë janë:

1. Të shtrijë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në mënyrë të unifikuar që garanton optimizimin e kostove në 97% të territorit të bashkisë.
2. Të sigurojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë se mbetjeve të gjeneruara dhe të garantojë eliminimin e të gjitha depozitimeve të përkohëshme të pakontrolluara brenda territorit të bashkisë.
3. Të sigurojë në mënyrë graduale infrastrukturën dhe zbatimin e skemës optimale të nevojshme për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar për të përmbushur objektivat kombëtare të reduktimit dhe ripërdorimit të mbetjeve.
4. Të sigurojë skema efektive në bashkëpunim me organizatat lokale dhe kompanitë e pastrimit për reduktimin e mbetjeve të destinuara për destinacionin final si shkak i aktivitetit të riciklimit dhe kompostimit.
5. Të realizojë në mënyrë graduale dhe në përputhje me parimin “ndotësi paguan” mbulimin e kostos së shërbimit nga të ardhurat prej tarifës duke marrë në konsideratë mundësitë dhe vullnetin e banorëve, bizneseve dhe institucioneve për të paguar.

Zbatimi i këtij Plani do të shtrihet në harkun kohor 5 vjeçar 2021 - 2025. Treguesit dhe buxheti i zbatimit të Planit monitorohen dhe rishikohen cdo vit në kuadër të procesit të përgatitjes së paketës fiskale dhe buxhetit vjetor të bashkisë.

Përsa i përket realizimit të objektivave ndarja e territorit të bashkisë në 3 zona shërbimi ka rezultuar efektive, si për menaxhimin nga ana e bashkisë, ashtu edhe për kryerjen e shërbimit nga operatërit që kryejnë shërbimin. Kjo ndarje do të vazhdojë të qëndrojë edhe në periudhën e parashikuar nga ky plan.

Zona e I-rë mbulon Njësitë Administrative:

1. Lezhë;
2. Shëngjin;

Shërbimi mbulon territorin e Zonës së I-rë të Bashkisë Lezhë (harta në vijim). Numri i përgjithshëm i banorëve rezident të Zonës I - rë të shërbimit është vlerësuar rreth 29,489 banorë (e llogaritur për vitin 2020) në periudhën Tetor – Prill, e cila shtohet me rreth 35,000 persona për çdo ditë në sezonin turistik Maj – Tetor, veçanërisht në zonën e Shëngjinit. Numri i popullsisë që do të marrin shërbim në këtë Zonë në vitin 2021 është vlerësuar në rreth 29,489 banorë rezidentë (pa përfshirë këtu popullsinë vizitore (turistët). Ndërsa llogaritja për periudhën e sezonit turistik është bërë më vete, duke llogaritur kohë shërbimi prej 5 muaj (150 ditë)

Kufijtë e Zonës së Shërbimit nuk përputhen domosdoshmërisht me kufijtë administrativ të Njësiteve Administrative ku shtrihet shërbimi.




Figura 6: Shtrirja e zonave të shërbimit të ndara sipas kategorive.

Zona II mbulon Njësitë Administrative:

1. Shënkoll;
2. Zejmen;
3. Kolsh;

Kufijtë e Zonës së Shërbimit nuk përputhen domosdoshmërisht me kufijtë administrativ të Njërive Administrative ku shtrihet shërbimi.

Shërbimi mbulon të gjithë territorin e Zonës II të Bashkisë Lezhë (figura. 6). Numri i përgjithshëm i banorëve rezident të Zonës II të shërbimit e llogaritur rreth 22,645 banorë (e llogaritur për vitin 2020). Norma e gjenerimit për këtë njësi është llogaritur 0.5 kg/banor/ditë, për shkak se zona ka një zonë të theksuar industriale përgjatë superstradës SH1/E762, si dhe një frekuentim të lartë të plazhit në zonën e Tales gjatë sezonit të verës.

Zona III mbulon Njësitë Administrative:

1. Balldre;
2. Kallmet;
3. Ungrej;
4. Dajç;
5. Blinisht;

Kufijtë e Zonës së Shërbimit për zonën e III-të përputhen me kufijtë administrativ të Njërive Administrative ku shtrihet shërbimi. Shërbimi mbulon të gjithë territorin e Zonës III të Bashkisë Lezhë (figura. 6). Numri i përgjithshëm i banorëve rezident të Zonës III të shërbimit e llogaritur rreth 23,590 banorë (e llogaritur për vitin 2020).

12.2 Rezultatet dhe treguesit

Rezultatet

Përcaktimi i rezultateve të dëshiruara qëndron në thelb të punës për hartimin e PMIM-së, bazuar mbi matjen e performancës. Përcaktimi i rezultateve dhe treguesve shërben për të gjeneruar ide, për të vendosur dhe menduar se çfarë do të jetë më e rëndësishme, si dhe për të marrë një vendim përfundimtar mbi zhvillimin e shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve. Shtresëzimi i rezultateve, nga disa rezultate të ndërmjetme deri tek rezultati përfundimtar, ndihmon për të bërë zgjedhjet e duhura, si në rastin e këtij Plani, për të mos zbehur fokusin e përpjekjeve për të përmirësuar shërbimin dhe për të lehtësuar procesin e matjes dhe monitorimin performancës së Bashkisë në këtë fushë.

Për të përmbushur objektivat e këtij plani, bashkia Lezhë ka vendosur këto tregues për objektivat që do të realizohen nga zbatimi i Planit.

Objektivi 1: Te shtrijë shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve në mënyrë të unifikuar që garanton optimizimin e kostove në 97% të territorit të bashkisë.




Figure 1 Objektivi 1 i ofrimit të shërbimit

Në fund afatit të zbatimit të planit (2025) bashkia do të synojë të mbulojë dhe të grumbullojë mbetjet nga jo më pak se 97% e popullsisë të saj.

Objektivi 2: Të garantoje grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të gjeneruara brenda territorit të bashkisë.

Në lidhje me këtë objektiv bashkia Lezhë synon:

- Të planifikojë një sistem adekuat të grumbullimit të mbetjeve duke krijuar itinerare për secilën zone shërbimi dhe orare të përshtatshme për të siguruar tërheqjen e të paktën 97% e të gjitha mbetjeve të gjeneruara.

	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Zona 1	99	99	100	100	100	100
Zona 2	98	98	100	100	100	100
Zona 3	89	89	90	93	95	95
total	95	96	96	96	96	97

Table 2 Objektivi në % i mbledhjes së mbetjeve të gjeneruara

Objektivi 3: Të sigurojë në mënyrë graduale infrastrukturën dhe zbatimin e skemës optimale të nevojshme për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar për të përmbushur objektivat kombëtare për reduktimin e mbetjeve.

Për të arritur këtë objektiv, bashkia Lezhë do të synojë ofrimin e këtij shërbimi në dy standarde sipas ndarjes territoriale në tre zonat e shërbimit.

1. Zona 1:

- Qyteti Lezhë: procesi i reduktimit nëpërmjet riciklimit planifikohet të rifillojë në vitin 2022 në bashkëpunim me organizata mjedisore dhe shkollat e qytetit;
- Qyteti i Shëngjinit: jemi në diskutime me grupet e interesit për gjetjen e një skeme funksionale që impenjon të gjitha palët, bashkinë, bizneset, operatorin dhe qytetarët për grumbullimin e diferencuar në të gjithë qytetin gjatë verës dhe vetëm në pjesën e qendrës gjatë periudhës së dimrit. Aktualisht në Shëtitoren Uillson, Bashkia ka vendosur 15 PGM për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve si projekt pilot.

2. Zona 2 dhe 3

- Në Zonën e II dhe të tretë do të synohet bashkëpunimi me bizneset e zonës, sidomos në zonat me frekuencë të lartë turistike si plazhi I Tales dhe zona Fishtë-Troshan për futjen sidomos të procesit të kompostimit të mbetjeve.

4. E gjithë bashkia

- Përsa i përket riciklimit në zonat rurale të bashkisë Lezhë do të fillojë pilotimin e mbledhjes derë me derë të mbetjeve të riciklueshme me qese 1 here në javë në zona të cilat do të për zgjidhen nga bashkia gjatë vitit 2022.

Objektivi 4: Të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në landfill si shkak i aktivitetit të riciklimit dhe kompostimit.


Duke u bazuar në rezultatet e mësipërme për riciklimin e mbetjeve të njoma dhe të thata, bashkia ka vendosur një objektiv specifik për reduktimin e mbetjeve të cilat depozitohen në landfillin e Bushatit.

Nepërmjet aplikimit të një skeme ndërgjegjësimi dhe sistemi penalitetesh, qytetarët do të orientohen që mbejtjet e gjelbra dhe shumë mbetje ushqimore të mos hidhen nëpër kontenierët e grumbullimit të mbetjeve *urbane*, por të krijohen skema kompostimi dhe ripërdorimi, në mënyrë që të reduktohen mbetjet që shkojnë në landfill. Në këtë mënyrë parashikohet që në të gjithë territorin e bashkisë në fund të afatit të këtij plani sasia e mbetjeve që depozitohen në landfill do të reduktohen me rreth 20%.

Objektivi 5: Të realizojë në mënyrë graduale dhe në përputhje me parimin “ndotësi paguan” mbulimin e kostos së shërbimit nga të ardhurat prej tarifës.

Për të realizuar këtë objektiv, bashkia do të vendosi një sistem tarifor i cili do të mbulojë kostot e ofrimit të shërbimit të largimit të mbetjeve të ngurta urbane nga territori i bashkisë. Gjithashtu norma e mbledhjes së tarifave do të planifikohet e njëjtë pavarësisht zonave të shërbimit. Kjo për arsye se llogaritja e kostove është ndare sipas Zonave të shërbimit.

	2020	2021	2022	2023	2024	2025
familjare	14,206,000	15,626,600	17,189,260	18,908,186	20,799,005	22,878,905
biznes I vogël	14,055,000	15,460,500	17,006,550	18,707,205	20,577,926	22,635,718
biznes I vogël	24,987,000	26,236,350	27,548,168	28,925,576	30,371,855	31,890,447
institucione	273,000	354,900	461,370	599,781	779,715	1,013,630
Totale	53,521,000	57,678,350	62,205,348	67,140,748	72,528,500	78,418,700



13. Plani operativ i menaxhimit të integruar të mbetjeve

Projeksioni i popullsisë 2020-2026

Duke marrë në konsideratë një rritje të popullsisë prej 0,3% në vit (afërsisht sa rritja natyrore mesatare vjetore kombëtare, popullsia në bashkinë Lezhë në vitin 2025 parashikohet në rreth 92,334 banorë.

Zone Shërbimi në bashkinë Lezhë në përgjithësi në intervalin kohor 2021 – 2026 duke u nisur nga të dhënat e vitit 2019 si viti krahasimor bazë në hartimin e këtij Plani.

Table 3 Projeksioni i popullsisë⁵ në Bashkinë Lezhë 2020- 2025 sipas çdo njësie administrative.

Njësia Administrative	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Lezhë	20,285	20894	21520	22166	22831	23516
Shëngjin	9,503	9788	10082	10384	10696	11017
Ballëdren	7,582	7809	8044	8285	8534	8790
Blinisht	4,084	4207	4333	4463	4597	4734
Dajç	4,854	5000	5150	5304	5463	5627
Kallmet	5,083	5235	5393	5554	5721	5893
Kolsh	5,140	5294	5453	5617	5785	5959
Shënkoll	14,263	14691	15132	15586	16053	16535
Ungrej	1,985	2045	2106	2169	2234	2301
Zejmen	6,869	7075	7287	7506	7731	7963
Totali	79,648	82,037	84,499	87,034	89,645	92,334

Table 4 Projeksioni i popullsisë 2020-2025 sipas zonave të mbetjeve

Zona mbetjeve	2020	2021	2022	2023	2024	2025
zona 1	29,788	30,682	31,602	32,550	33,527	34,532
zona 2	26,272	27,060	27,872	28,708	29,569	30,456
zona 3	23,588	24,296	25,025	25,775	26,549	27,345
Totali	79,648	82,037	84,499	87,034	89,645	92,334

Në vijim grafiku ilustron në mënyrë të përmblëdhur projeksionin e popullsisë në bashkinë Lezhë sipas zonave të mbetjeve, duke përfshirë edhe zonën 4 (turistike).

⁵ Projeksioni i popullsisë është llogaritur me rritje 3% në vit, me vit bazë vitin 2020




Figure 2 Projeksioni i popullsisë sipas zonave përfshirë zonën turistike

Sasia dhe struktura e përbërjes së mbetjeve

Sasia aktuale totale e mbetjeve llogaritet në rreth 17,000 ton/vit duke marrë në konsideratë normat 0.7 kg/banor/ditë për zonat urbane dhe 0.44 kg/banor/ditë për zonat rurale⁶. Në vitin 2020 sasia e mbetjeve që gjenerohen në Lezhë vlerësohet rreth 19,535 ton/vit ndërsa në 2026 kjo sasi parashikohet në rreth 19,595 ton/vit.

Nga llogaritjet rezulton se rreth 31% e mbetjeve në Lezhë përbëhen nga fraksione të riciklueshme përfshirë letër/karton, plastikë, qelq, metale. Politika e bashkisë në këtë kuadër do të fokusohet në hartimin e projekteve të zbatueshme në bashkëpunim me të gjithë aktorët e interesuar, përfshirë organizatat joqeveritare dhe kompanitë e pastrimit, për ndarjen në burim të këtyre mbetjeve, grumbullimin, selektimin dhe tregtimin e tyre për industrinë e riciklimit, duke reduktuar kështu ndjeshëm mbetjet me destinacion venddepozitimin e Bushatit në përputhje më afate ligjore.

Rreth 69% e mbetjeve të Bashkisë Lezhë aktualisht janë mbetje të biodegradueshme (organike, dru dhe mbetje nga kuzhina, oborri, kafshët etj.), të përziera me mbetje të pa riciklueshme që do të thotë se në termat e Direktivave të BE mbi Landfilllet dhe SKMM, politikat e Bashkisë duhet të adresojnë menaxhimin e kësaj rryme në mënyrë të tillë që të inkurajojë kompostimin. Në mënyrë të veçantë bashkia do të inkurajojë këtë lloj trajtimi në zonat rurale në mënyrë që të ulen kostot e transportit si dhe sasia e mbetjeve me destinacion landfillin. Një fokus i veçantë për projektet e

⁶ Të dhënat për sasinë e mbetjeve të gjeneruara për çdo banorë në ditë janë marrë llogaritjet e bera nga EcoDes Studio sipas VKM 319, datë 31.05.2018.

kompostimit do të vendoset në zonat rurale me vokacion të lartë agriturizmin, edhe në bashkëpunim me restorantet e zonave.

Table 5 Projeksioni i sasisë së mbetjeve për secilën zonë gjatë viteve 2020-2025

	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Zona 1	7,534	7,572.11	7,573.11	7,574.12	7,575.12	7,576.12	7,577.13
Zona 2	3,306	3,307.17	3,308.18	3,309.18	3,310.18	3,311.19	3,312.19
Zona 3	3,444	3,445.14	3,446.15	3,447.15	3,448.15	3,449.16	3,450.16
Zona 4	5,250	5,251.00	5,252.01	5,253.01	5,254.01	5,255.02	5,256.02
Totali	19,535	19,575	19,579	19,583	19,587	19,591	19,595




Figure 3 Projeksioni i sasisë së mbetjeve për secilën zonë gjatë viteve 2020-2025

Norma e gjenerimit të mbetjeve

Duke u nisur nga sasia e mbetjeve të depozituara në landfill përgjatë periudhës 2017-2021, si dhe projeksionit të popullsisë, bashkia Lezhë ka një llogaritje të përafërt të normës së gjenerimit të mbetjeve për secilën zonë dhe rrjedhimisht edhe për secilin banor. Kështu në kuadër të hartimit të këtij plani, bazuar edhe në llogaritjet e kryera në kuadër të Planit kombëtar sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, kemi marrë për bazë këto norma gjenerimi:

- Norma e gjenerimit të mbetjeve nga popullsia urbane (zona 1) është konsideruar 0.7 kg/banor/ditë.

- Norma e gjenerimit të mbetjeve nga popullsia periurbane (zona 2) është llogaritur 0.5 kg/banor/ditë. Kjo normë përfshin edhe zonën industriale përgjatë aksit SH2/E761 dhe zonën turistike të Tales.
- Norma e gjenerimit të mbetjeve nga popullsia rurale (zona 3) është konsideruar 0.4 kg/banor/ditë.

Normat e tjera në vijim janë përdorur për llogaritjen e numrit të kontenierëve në vitet e zbatimit të planit. Këto norma përputhen edhe me matjet e bëra në terren dhe janë përdorur për analogji për hartimin e PMIM të bashkisë së Lezhës.

- Pesha mesatare e mbetjeve në një kontejner 1100 litra ose 1.1 m³ është 250 kg
- Pesha mesatare e mbetjeve mikse në një kontenierë 1100 litra ose 1.1 m³ i mbushur 85% plote = 212.5 kg
- Pesha mesatare e mbetjeve të riciklueshme në një kontenier 1100 litra ose 1.1 m³ është 150kg
- Pesha mesatare e mbetjeve të riciklueshme në një kontenierë 1100 litra ose 1.1 m³ i mbushur 75% plote = 112.5 kg

Mbi bazën e shtimit të popullsisë si dhe të një rritje të gjenerimit të mbetjeve prej 3% në vit për çdo vit të planit, në tabelën që vijon është paraqitur llogaritja e gjenerimit të mbetjeve për periudhën kohore të planit duke marrë si vit bazë të dhënat e vlerësuara për vitin 2019.

		2020	2021	2022	2023	2024	2025
Zona 1	Lezhë-Shëngjin	7,534	7,557	7,580	7,602	7,625	7,648
Zona 2	Kolsh-Zejmen-Shënkoll	3,306	3,316	3,326	3,336	3,346	3,356
Zona 3	Balldre-Kallmet-Dajç-Blinisht-Ungrej	3,444	3,454	3,465	3,475	3,486	3,496
Zona 4	Turistike Shëngjin	5,250	5,266	5,282	5,297	5,313	5,329
Totali		19,535	19,593	19,652	19,711	19,770	19,830

Table 6 Projektioni i gjenerimit të mbetjeve 2021 – 2025

Në grafikun që vijon janë ilustruar në mënyrë të përmblendhur rezultatet e tabelës më sipër për të treguar projektionin e gjenerimit të mbetjeve në bashkinë Lezhë në intervalin 2020 – 2025.




Figure 4 Projeksioni i gjenerimit të mbetjeve 2021 – 2026

13.1 Planifikimi teknik i menaxhimit të mbetjeve

Projeksioni për mbulimin me shërbimin e largimit të mbetjeve

Në terma relative dhe vlera të bazuara mbi llogaritjen e mesatares së ponderuar, në bashkinë Lezhë aktualisht mbulohet me shërbim rreth 95% e popullsisë. Për qëllimet e këtij plani ne kemi konsideruar se zgjerimi I shërbimit edhe në Ungrej në zonën 3 do të mbulonte plotësisht me shërbim të gjithë Bashkinë Lezhë. Gjithashtu, zgjerimi I shërbimit në zonën me frekuentim të lartë turistik, do të bënte të mundur edhe grumbullimin thuajse të plotë të sasisë së mbetjeve që gjenerohen.

PMIM 2021-2025 merr në konsideratë mbulimin 100% për zonën e parë të shërbimit, mbulim 100% për zonën e dytë të shërbimit dhe mbulimin deri në 95% për zonën e tretë të shërbimit, e cila është e përbërë nga relativisht zona të thella malore ku aksesimi me rrugë është i pamundur.

Grafiku në vijim ilustron planifikimin e rritjes së mbulimit me shërbim në harkun kohor 2020 – 2025.





Figure 5 Rritja e mbulimit me shërbim sipas Zonave të Shërbimit, 2020-2025

Në total dhe për të gjithë territorin e bashkisë projeksioni i mbulimit me shërbim në fund të periudhës së zbatimit të planit është projektuar në masën 97%. Grafiku në vijim pasqyron ndryshimin e mbulimit me shërbim për të gjithë bashkinë Lezhë në harkun kohor 2020 – 2025.



Grafiku 5: Rritja e mbulimit me shërbim në bashkinë Lezhë, 2020 - 2025

Projeksioni për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve

Një nga treguesit kryesorë të këtij plani është projeksioni për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve. Mbi bazën e këtij treguesi, dhe në varësi të formës që bashkia do të zgjedhe për administrimin e këtij shërbimi, bashkia do të planifikojë shpërndarjen e burimeve, përfshirë këtu ato njerëzore, mjetet financiare teknike dhe makineritë.

Projeksioni për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve është bazuar në projeksionet e mësipërme të cilat janë thelbësore për llogaritjen e projeksionit të grumbullimit dhe transportit.

Nga këto mund të përmendim:

1. projeksionin e popullsisë;
2. projeksionin e gjenerimit të mbetjeve, si dhe
3. projeksionin e shtrirjes së mbulimit me shërbim.

Llogaritja e projeksionit për këtë tregues është bërë për secilën zonë shërbimi. Baza e të dhënave që shoqëron këtë plan përmban llogaritjet për çdo Njësi Administrative. Llogaritjet e agreguara për të gjithë territorin e bashkisë Lezhë na japin situatën si në tabelën përmbledhëse që vijon.

	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Zona 1	7,534	7,557	7,580	7,602	7,625	7,648	7,671
Zona 2	3,306	3,316	3,326	3,336	3,346	3,356	3,366
Zona 3	3,444	3,454	3,465	3,475	3,486	3,496	3,507
Zona 4	5,250	5,266	5,282	5,297	5,313	5,329	5,345
Totali	19,535	19,593	19,652	19,711	19,770	19,830	19,889
% mbulimit	95%	96%	96%	96%	96%	97%	97%
totali I mbledhur	18,623	18,735	18,848	18,961	19,075	19,189	19,305

Tabela e mësipërme tregon që në periudhën e fundit të zbatimit të këtij plani, në terma absolutë, sasia e mbetjeve që do gjenerohet në territorin e bashkisë Lezhë në vitin 2021, duke marrë parasysh rritjen e popullsisë me 0.5% në vit dhe rritjen e gjenerimit me 1.3% në vit, është llogaritur të jete 19,889 ton/vit prej të cilave do të mblidhen rreth 97% krahasuar më 95% që mblidhen aktualisht.

- *Duhet të sqarohet që mbetjet që nuk do të grumbullohen i përkasin kryesisht fshatrave që aktualisht nuk aksesohen me rrugë.*

Vlen të theksohet se treguesi i “Mbetjeve që nuk Mblidhen” ose i mbetjeve që do të vazhdojnë të hidhen në mënyrë të pakontrolluar do të ulet në nivele maksimale siç parashikohet në vetëm 3% të sasisë së mbetjeve që do të gjenerohen në të gjithë territorin e bashkisë.

Këto projeksione tregojnë për një plan ambicioz të bashkisë Lezhë si dhe një rritje të ndjeshme të mbulimit dhe cilësisë së shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave.

Projeksioni për shpërndarjen e kontenierëve dhe frekuencat e grumbullimit

Ky plan ka për qëllim gjithashtu të pasqyrojë një projeksion të detajuar të nr. të PGM, nr. e kontenerëve dhe përbërjen e çdo PGM-je për të gjitha zonat e shërbimit. Autoriteti përkatës që do të merret me ofrimin e shërbimit do të furnizojë dhe vendose në sistem gjithsej 1,006 kontenerë në periudhën qershor - gusht dhe 590 kontenerë në periudhën shtator – maj (sasia e kontenerëve në përdorin jashtë sezonit turistik do të ulet me 416 kontenerë për zonën I). Gjatë vlerësimit të situatës në terren, Bashkia ka vlerësuar se nuk egziston hapësira fizike për vendosjen e kaq shumë kontejnerëve, dhe për këtë arsye gjatë matjeve në terren është evidentuar një numër maksimal koshash prej 430 për gjithë zonën, por që gjatë sezonit të lartë këto kosha do të zbrazen të paktën 2 herë në ditë, për të lejuar që mbetjet të grumbullohen të gjitha në konteiner.

Zona 1 e shërbimit

Në planin e mëparshëm sasia e konteinerëve dhe e itinerareve ishte përcaktuar nisur nga kufinj të administrativë të njërive, por gjatë zbatimit të planit u vu re se këto kufizime nuk qëndrojnë. Për këtë arsye, në këtë plan sasia e konteinerëve, itineraret si dhe PGM do të përcaktohet sipas zonave të shërbimit, pa marrë parasysh kufinj të njërive administrative, por efektivitetin e itinerareve të kamionëve. Gjatë punës në terren është evidentuar rishikimi I vendosjes së konteinerëve sipas skemës së Mëposhtme.

ZONA 1	PIKA EGZISTUESE	KONTENIER EGZISTUES	PIKA PER TE SHTUAR	KONTENIER PER TE SHTUAR	PIKA TOTAL	KONTENIER TOTAL
	128	285	15	88	143	373

Duke u nisur nga kjo premisë, ndarja e konteinerëve për zonën 1 është si më poshtë:

- 285 konteinerë për mbetje të përziera funksionale gjatë gjithë vitit,
- 185 konteinerë shtesë për mbetjet të përziera që funksionojnë gjatë sezonit turistik maj-tetor.

Të gjithë këta konteinerë do të shpërndahen në **143 PGM** sipas itinerareve.

- 36 PGM në zonën e Shëngjinit gjatë me gjithsej 95 kontenierë që do mblidhen me dy turne në stinën e verës;
- 107 PGM për grumbullimin e mbetjeve gjatë gjithë vitit;

Frekuenca e grumbullimit Zona I

Percaktimi I itinerareve (Brenda dhe jashte sezonit turistik)

Për të patur një efektivitet sa më të madh të mbledhjes së mbetjeve urbane, janë përcaktuar dy itinerare kryesore gjatë periudhës së dimrit, dhe tre itinerare me frekuencë të shtuar gjatë stinës së verës, kur edhe kemi frekuentim të lartë turistik. Këto itinerare nuk janë definitive, dhe do të jenë supervizorët e shërbimit së bashku me operatorin që do të kryejë shërbimin që do të përcaktojnë grafikun e saktë të punës, për cdo periudhë raportimi.

Itinerari 1 (jo sezon) – Rana e Hedhun, Kune, Ishull-Shëngjin, Ishull-Lezhë, SMT, Lalm i ri 3 herë në javë,

Itinerari 2 (jo sezon) – Shëngjin qendër, Sakë, Rruga Shëngjinit, Kodër Marlekaj, Besëlidhja, Pazari, Gurra, Bul. Fishta, Lagjia Skënderbeg. 7 herë në javë

Itinerari 3 (sezon) – Ishull Shëngjin, Ishull Lezhë, SMT, Lalm I ri, 7 herë në javë

Itinerari 4 (sezon) – Bul. Nënë Tereza, Rana e Hedhun, Shëngjin Port, Bul. Uillon, Sakë, Kune. 14 herë në javë.

Itinerari 5 (sezon) - Kodër Marlekaj, Besëlidhja, Pazari, Gurra, Bul. Fishta, Lagjia Skënderbeg. 7 herë në javë

Periudha Jashtë Sezonit Turistik

Gjatë periudhës jashtë sezonit turistik (tetor – prill) do të angazhohen tre mjete; respektivisht 2 mjete për grumbullimin e mbetjeve të përziara ose të pariciklueshme, kamiona vetëshkarkues 10t, ose 1 mjet me dy turne. Sidoqoftë rekomandohet që kompania të disponojë 2 mjete për këtë periudhë të vitit, si dhe një mjet të hapur për grumbullimin e mbetjeve në zona të vështira.

Itinerari	Mjeti	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E shtunë	E dielë
Itinerari 1 – Rana e Hedhun, Kune, Ishull-Shëngjin, Ishull-Lezhë, SMT, Lalm i Ri	I							
Itinerari 2 – Shëngjin qendër, Sakë, Rruga Shëngjinit, Kodër Marlekaj, Besëlidhja, Pazari, Gurra, Bul. Fishta, Lagjia Skënderbeg.	II							

Periudha gjatë Sezonit Turistik

Gjatë periudhës së frekuentimit të lartë turistik (maj – shtator) do të angazhohen katër mjete; respektivisht 3 mjete për grumbullimin e mbetjeve të përziara dhe 1 kamion vetëshkarkues 10t, që punojnë me dy turne. Sidoqoftë rekomandohet që kompania të disponojë të paktën 4 mjete teknologjike për këtë periudhë të vitit, si dhe të paktën një mjet të hapur për grumbullimin e mbetjeve në zona të vështira.

Itinerari	Mjeti	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E shtunë	E dielë
Itinerari 3 – Ishull Shëngjin, Autostrade, Ishull Lezhë, SMT, Lalm i ri	I							
Itinerari 4 – Bul. Nënë Tereza, Rana e Hedhun, Shëngjin Port, Bul. Uillon, Sakë, Kune.	II & III							
Itinerari 5 - Kodër Marlekaj, Besëlidhja, Pazari, Gurra, Bul. Fishta, Lagjia Skënderbeg.	IV							

Zona 2 e shërbimit

Operatori që do të ofroje shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonë 2 të bashkisë Lezhë (Shënkoll, Zejmen, Kolsh) do të furnizojë dhe vendose në sistem **169 kontenierë** në 114 PGM për gjithë zonën sipas itinerareve të Pikave për Grumbullimin e Mbetjeve siç janë paraqitur në tabelat në vijim dhe hartat shoqëruese Aneksi 2.

	PGM	kosha
Shënkoll	30	41
Tale	24	33
Rrilë	23	34
Zejmen	27	43
Kolsh	10	18
Gjithsej	114	169

Gjithashtu gjate periudhës se ofrimit të shërbimit do të rishikohet numri, shpërndarja e Pikave të grumbullimit të Mbetjeve dhe numri i kontenierëve kur vlerësohet e nevojshme, për të përmirësuar efektivitetin e organizimit të shërbimit dhe optimizimin e kostove.

Numri i kontenierëve do të dyfishohet në zonën e plazhit në njësinë Shënkoll gjatë muajve qershor – gusht për të përballuar gjenerimin e shtuar të mbetjeve nga fluksi i pritshëm i turistëve në këtë zonë.

Itineraret dhe Frekuenca e grumbullimit Zona II

Gjatë periudhës së zbatimit të PMIM 2021-2025, është evidentuar se itineraret e nevojshme për të përballuar shërbimin janë 2 dhe rrjedhimisht do të angazhohen dy mjete; respektivisht 2 mjete për grumbullimin e mbetjeve të përziera ose të pariciklueshme. Sidoqoftë rekomandohet që kompania të disponojë 2 mjete teknologjike si dhe një mjet të hapur për grumbullimin e mbetjeve në zona të vështira.

Itinerari 1- Autostradë, Rrilë, Tale, Shënkoll

Itinerari 2 – Gajush, Zejmen, Kolsh, Autostradë

Grumbullimi i mbetjeve urbane në **Zonën II** të shërbimit të bashkisë Lezhë do të kryhet në një frekuence 3 herë jave për 52 jave gjatë gjithë vitit sipas itinerareve si më sipër. Gjatë sezonit turistik, do të jetë e nevojshme të shtohet një itinerar tjetër për mbledhjen e mbetjeve të shkatuara

nga frekuentimi I lartë turistik në plazhin e Tales dhe në rrugën hyrëse, me një frekuencë 7 herë në javë. Grafiku i grumbullimit paraqitet si më poshtë vijon:

Grafiku i grumbullimit të mbetjeve për zonën 2:

Itinerari	Mjeti	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E shtunë	E dielë
Itinerari 1- Autostradë, Rrilë, Tale, Shënkoll	I							
Itinerari 2 – Gajush, Zejmen, Kolsh, Autostradë	I							
Itinerari turistik – Tale – Shënkoll – Autostradë	II							

Zona 3 e shërbimit

Autoriteti që do të ofroje shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Lezhë do të furnizojë dhe vendose në sistem **312 kontenierë** për Zonën e III-të të shërbimit të shpërndarë në **261 PGM** sipas itinerareve të Pikave për Grumbullimin e Mbetjeve siç janë paraqitur në tabelat në vijim dhe hartat shoqëruese Aneksi 2.

Duhet theksuar se për këtë zonë, sasia e mbetjeve të gjeneruara sipas përlllogaritjeve të bëra nga EcoDes, bazuar në VKM 319, rekomandojnë vendosjen e 176 kontenierëve me një frekuencë 3 herë në javë. Duke qenë se territori që mbulohet është i madh, dhe me një popullsi kryesisht rurale të shpërndarë në shumë fshatra, grupi i punës së bashkisë rekonadon vendosjen e kontenierëve sipas tabelës më poshtë, dhe mbledhjen e mbetjeve me frekuencë 2 herë në javë.

	PGM	Kontenierë
Balldre	71	86
Kallmet	68	74
Dajc	65	79
Blinisht	57	73
gjithsej	261	312

Itineraret dhe Frekuenca e grumbullimit Zonën 3

Gjatë periudhës së zabtimit të PMIM 2021-2025, është evidentuar se itineraret e nevojshme për të përballuar shërbimin janë 2 dhe do të angazhohet një mjet; 1 mjet për grumbullimin e mbetjeve të përziera ose të pariciklueshme. Sidoqoftë rekomandohet që kompania të disponojë 1 mjet teknologjike si dhe një mjet të hapur për grumbullimin e mbetjeve në zona të vështira.

Itinerari 1- Torovicë, Balldren, Kakarriq, Gocaj, Gjadër, Gramsh, Autostradë 2)

Itinerari 2 – Raboshtë, Mërqi, Kallmet, Piraj, Blinisht, Troshan, Fishtë, Krajen, Kotërr, Dajç, Autostradë.

Grumbullimi i mbetjeve urbane në Zonën 3 të shërbimit të bashkisë Lezhë do të kryhet në një frekuencë 2 herë jave për 52 javë gjatë gjithë vitit sipas itinerareve si më sipër. Grafiku i grumbullimit paraqitet si më poshtë vijon:

Itinerari	Mjeti	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E shtunë	E dielë
Itinerari 1- Torovicë, Balldren, Kakarriq, Gocaj, Gjadër, Gramsh, Autostradë	I							
Itinerari 2 – Raboshtë, Mërqi, Kallmet, Piraj, Blinisht, Troshan, Fishtë, Krajen, Kotërr, Dajç, Autostradë.	I							

14. Plani financiar i shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve

14.1 Kosto e shërbimit 2021-2025

Kosto e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve ndahet sipas llojit të shpenzimit dhe veprimtarisë së shërbimit që kryhet përmes tij, në zërat e mëposhtëm:

A. Kosto operative

- a. Kostot e mirëmbajtjes: mjete të shërbimit
- b. Kostot e mbledhjes: karburant i përdorur gjatë shërbimit
- c. Kosto transporti: karburant i përdorur gjatë shërbimit
- d. Kosto depozitimi: tarifa për trajtimin e mbetjeve në landfill
- e. Kosto personeli: shoferë dhe punëtorë

- f. Kosto amortizimi: mjete të shërbimit
- g. Kosto larje dhe dezinfektim: për kontenierët

B. Kosto kapitale

- a. Kosto e blerjes së mjeteve të shërbimit

Në realizimin e shërbimit marrin pjesë, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, dhe drejtues e nëpunës specialistë të bashkisë, shpenzimet për të cilët vlerësohen në masën 8 % të koston operative dhe përfshihen në zërin:

C. Kosto administrative

Bazuar në objektivin e Bashkisë Lezhë për të dhënë shërbimin me nen kontraktim tek një operator privat, i cili do të zgjidhet nëpërmjet proceduarve ligjore të prokurimit publik, mbi koston operative të shërbimit është llogaritur e ardhura neto e pritur, në masën 10 %; ky shpenzim përfshihet në zërin e koston:

D. Të ardhura neto

Vlera gjithsej e koston së shërbimit llogaritet me TVSH në masën 20 % të koston operative rënduar me koston administrative dhe të ardhurat e pritura neto.

E. Tatim mbi Vlerën e Shtuar

Llogaritja e kostove të mësipërme është në përputhje me metodën e Llogaritjes së Koston së Plotë (Full Cost Accounting), dhe në zbatim të Planit Teknik dhe Operacional të realizimit të shërbimit. Këto kosto paraqiten:

- a. për çdo zonë të bashkisë Lezhë, në funksion të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve,
- b. për çdo itinerar të përshkruar nga kamioni i mbledhjes së mbetjeve,
- c. sipas llojit të mbetjeve: (i) të riciklueshme, të (ii) të pariciklueshme dhe (iii) mikse.

14.1.1 Kosto operative të shërbimit

Përllogaritja e koston është bërë bazuar në VKM 319, datë 31.05.2018, që përmban dokumentin “Udhëzues për llogaritjen e kostove për menaxhimin e mbetjeve”

Dispozitat e përgjithshme të modelit të llogaritjes sipas këtij udhëzuesi të cilave u jemi përmbajtur edhe për llogaritjen e kostove për këtë plan, janë si më poshtë.

Sistemi standard i llogaritjes së koston për menaxhimin e mbetjeve për një (njësi e vetëqeverisjes vendore) NJVV të vetme duhet të bazohet në të paktën 6 nga blloqet e të dhënave të mëposhtme 1:

- Të dhënat e përgjithshme për njësinë administrative apo zonën e shërbimit (blloku 1);
- Investimet kapitale (kamionët dhe kazanët e nevojshëm) (blloku 2);
- Kostot operative (mirëmbajtje, transport dhe personel) (blloku 3);
- Kostoja për trajtim në landfill (tarifa e trajtimit) (blloku 4);
- Kostot e amortizimit (riinvestimit) (blloku 5);
- Kostot administrative (blloku 6);
- Përlllogaritja e kostove totale të shërbimit (blloku 7).

Të gjitha pikat e mësipërme dhe elementet përkatëse që i përmbledhin ato, mund të modelohen në sistem bazuar në programin Excel, i cili duhet të jetë në gjendje të ofrojë të gjithë infrastrukturën përkatëse, burimet njerëzore dhe mjetet financiare të nevojshme për funksionimin e sistemit të menaxhimit.

Kostot operative vjetore të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve për vitet 2021-2025, me TVSH, paraqiten në tabelën në vijim, të ndara sipas zonave të shërbimit dhe gjithsej për bashkinë Lezhë.

Zonat e shërbimit	Shpenzime operative të planifikuara lekë/vit				
	2021	2022	2023	2024	2025
zona 1	49,157,775	51,615,664	54,196,447	56,906,269	59,751,583
zona 2	14,874,473	15,618,197	16,399,106	17,219,062	18,080,015
zona 3	14,671,327	15,404,893	16,175,138	16,983,895	17,833,090
Bashkia Lezhë	78,703,575	82,638,754	86,770,691	91,109,226	95,664,687

Table 7 Përlllogaritja e shpenzimeve operative 2021-2025

Një vlerë shtesë në masën 5 % është zbatuar mbi koston operative të shërbimit duke filluar nga viti 2021; kjo vlerë ka për qëllim të korrigjojë vlerat në vite të zërave të kësaj kostoje, llogaritur mbi bazën e çmimeve aktuale, me inflacionin mesatar vjetor të mundshëm, si dhe me shumën e një fondi rezervë i cili duhet të mbulojë shpenzime të papritura ose në rritje për arsye të tjera të paparashikueshme.

14.1.2 Kosto kapitale

Kosto kapitale përfaqëson investimin në automjete dhe mjete për realizimin e shërbimit, të cilat përfshijnë kontenierë dhe kamionë që do të përdoren për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve.

Për realizimin e shërbimit në vitet 2021-2025 nevojiten kamionë teknologjik, me vetëshkarkim, të tonazhit 10 dhe 12 ton, si dhe kamionë me vinç për mbledhjen e kontenierëve me qëllim larjen dhe dezinfektimin e rregullt të tyre, me kapacitet maksimal mbajtës prej 20 kontenierësh. Vlerë e shtuar

në menaxhimin korrekt të mbetjeve janë edhe kamionët e vegjël të hapur që duhet të operojnë në pikat e vështira në secilën prej zonave. Vlera e investimit total paraqitet në tabelën në vijim, e ndarë në çdo zonë dhe sipas karakteristikat më kryesore të tyre.

Në mënyrë të ngjashme paraqitet në tabelën e mëposhtme dhe vlera e investimit për kontenierë, sipas numrit të tyre në secilën zonë. Një shtesë investimi është planifikuar për zonën e parë dhe të dytë, në zonën e plazheve të Ranës së Hedhun, Shëngjin, Kune dhe Tale, pas vlerësimit të nevojës për ndërhyrje më të fortë në këto zona.

	Kosto Investimi	Nr. Kontenierëve 1.1 m3	Nr. mjeteve 10 ton
Kosto Zona 1 (Lezhe & Shëngjin)	13,585,627 Lekë	245	1
Kosto zona 2 (Shënkoll, Zejmen & Kolsh)	10,914,879 Lekë	169	1
Kosto Zona 3 (Balldre, Kallmet, Dajç, Blinisht dhe Ungrej)	11,161,714 Lekë	176	1
Kosto Zona 4 (zona turistike Shëngjin)	24,557,338 Lekë	416	2
Totali	60,219,558 Lekë	1006	5

14.1.3 Kosto ndërgjegjësimi

Ndërkohë që pjesë e rëndësishme e edukimit mjedisor të komuniteteve është edhe edukimi për menaxhimin e mbetjeve, gjë që do të realizohet me anë të angazhimit të organizatave lokale e kombëtare të shoqërisë civile, drejtorive përkëtesë në bashki si dhe drejtorive rajonale të dekoncentruara.

Ndërkohë që edukimi dhe ndërgjegjësimi është edhe pjesë e punës kontraktuale të operatorëve që do të bëjnë shërbimin e pastrimit, pasi në llogaritjen e kostos është mbajtur edhe një 2% për këtë qëllim.

Kosto ndërgjegjësimi	
zona 1	482,926
zona 2	272,926
zona 3	269,199
zona 4	419,052
total	1,444,102

Table 8 Kosto ndërgjegjësimi pjesë e llogatijes totale të kostos për secilën zonë

14.1.4 Kosto shërbimi për njësi

Grafikët që kemi paraqitur më poshtë japin një projeksion të kostove për njësi shërbimi të menaxhimit të mbetjeve në secilën nga zonat e bashkisë dhe për bashkinë në tërësi. Në këto grafikë duhet të kemi parasysh se kosto e zonës 1 përfshin edhe koston e zonës turistike, gjë e cila I rrit paksa vlerën të gjithë zonës 1 dhe kostot për njësi në rang bashkie.

Grafiku i mëposhtëm paraqet kostot në rritje për ton mbetje në vit që mblidhen në bashkinë Lezhë.




Figure 6 Projeksioni i rritjes së koston lek/ton/vit

Grafiku i mëposhtëm paraqet kostot në rritje për banor në vit, në bazë të numrit të banorëve që marrin shërbim në bashkinë Lezhë.




Figure 7 Projeksioni i rritjes së koston për banor/vit 2021-2025

14.2 Planifikimi i mbulimit të kostove

Qëndrueshmëria financiare e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve do të mbështetet në faktorët e mëposhtëm:

1. efektivitetin e organizimit të shërbimit,
2. eficiencën e kostos së shërbimit,
3. efektivitetin e monitorimit të shërbimit,
4. sistemin e tarifimit nëpërmjet të cilit mbulohet kosto e plotë e shërbimit,
5. efektivitetin e mbledhjes së të ardhurave nga tarifa e shërbimit.

Secili prej tyre është faktor kyç për të gjithë ciklin e menaxhimit financiar të shërbimit; kjo do të thotë se mbarëvajtja në lidhje me njërin mund të ndihmojë të gjithë ciklin, sikurse mos përmbushja e tij mund ta pengojë atë.

Në zbatim të PMIM 2017-2021, Bashkia Lezhë ka nisur në vitin 2018 mbledhjen e tarifës së shërbimit me agjent mbledhës Ujësjellës –Kanalizime Lezhë, dhe kjo ka bërë një rritje të efektivitetit të mbledhjes së tarifave në mënyrë shumë të dukshme. Duke qenë se janë në proces ndërtimi të ujesjellësve edhe në disa zona të tjera që më parë nuk mbuloheshin nga ky shërbim, besojmë se mbledhja e tarifës së shërbimit publik do të vijë duke u përmirësuar çdo vit.

Katër faktorët të cilët përcaktohen nga efektiviteti dhe efienca, janë parime udhëheqëse të planifikimit të shërbimit të kryer në Bashkinë Lezhë për vitet 2017-2021; gjë e cila do të vazhdojë të zbatohet edhe përgjatë periudhës së PMIM '21-'25. Kjo do të thotë se sistemi i organizimit të shërbimit, monitorimit të tij dhe i mbledhjes së të ardhurave në këtë plan janë parashikuar të sigurojnë efektivitet të ciklit të plotë të shërbimit dhe eficiencën e kostos së tij. Nga ana tjetër, zbatimi i këtyre sistemeve do të jetë i lidhur ngushtë me aftësinë e nëpunësve administrativë të Bashkisë, punonjësve të operatorit privat që do të realizojë shërbimin si dhe të shoferëve dhe punëtorëve të terrenit; për rrjedhojë, qëndrueshmëria financiare do të varet nga aftësia e burimeve njerëzore për përmbushjen e këtyre faktorëve.

Sa i përket sistemit të tarifimit nëpërmjet të cilit mbulohet kosto e plotë e shërbimit, do të ketë një strukturë të mbështetur në shtyllat e mëposhtme:

- Ndotësi paguan;
- Shpërndarje e drejtë e barrës së kostos ndërmjet grupeve të subjekteve gjenerues;
- Shpërndarje e drejtë e barrës së kostos brenda për brenda grupeve të subjekteve gjenerues
- Subjektet gjeneruese të cilat paguajnë tarifë rëndohen përkohësisht me barrën e kostos së subjekteve gjenerues të cilët nuk paguajnë;
- Fushata ndërgjegjësuese dhe edukuese për mbrojtjen e mjedisit dhe masa shtrënguese për të paguar tarifën ndërmerren nga Bashkia me objektiva të përcaktuara të masës dhe kohës së rritjes së % së subjekteve gjeneruese që paguajnë.

Këto shtylla përfaqësojnë parime dhe politika vendore të domosdoshme për të siguruar një sistem tarifimi i cili mbulon vlerën e plotë të kostos së shërbimit. Në mënyrë të ngjashme me grupin e parë të faktorëve, edhe në këtë rast, aftësia e burimeve njerëzore të bashkisë për të vënë në jetë këtë sistem është përcaktuese për qëndrueshmërinë financiare të shërbimit, më shumë se sa planifikimi i tij.

Në mënyrë të veçantë, përmbushja e objektivave të rritjes së % së subjekteve gjenerues që paguajnë është thelbësore për të siguruar zbatimin afatgjatë të këtij sistemi tarifimi, i cili bazohet në mirëkuptimin e banorëve që paguajnë për të mbajtur përkohësisht barrën e banorëve që nuk paguajnë.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e nevojshme për përlogaritjen e një tarife mesatare në vite për subjektet pagues për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

	2021	2022	2023	2024	2025
% e planifikuar e realizimit	95%	95%	96%	97%	97%
Kosto e planifikuar e shërbimit për t'u shpërndarë	78703575	82638754	86770691	91109226	95664687
Numri i familjeve *	21717	22369	23040	23731	24443
Numri i bizneseve tw mwdha **	2003	2043	2084	2126	2168
Numri i bizneseve tw vogla**	582	594	606	618	630
Numri i institucioneve	33	33	33	33	33

*Numër i përafshuar për madhësi mesatare të familjes, 4 anëtarë


**Numër i përafshuar mbi bazën e rritjes mesatare vjetore të PBB-së në vend, 2%

Nga analiza e kryer mbi mbledhjen e të ardhura gjatë periudhës së zbatimit të planit 2017-2021, ka rezultuar se biznesi I madh me pagesë prej 93% ka qenë kontribuesi më I madh në skemë, ndërkohë që familjarët me pagesë 66% dhe biznesi I vogël me pagesë prej 86% kanë një barrë të njëjtë. Bië në sy që norma e pagesës së tarifës së shërbimeve për kategorinë institucione është vetëm 10%, gjë që duhet sistemuar sa më shpejt të jetë e mundur. Barra e kostos së shërbimit ndahet midis familjeve, bizneseve dhe institucioneve, subjekte gjenerues të mbetjeve urbane. Duke u nisur nga sasia konkrete e mbledhjes së tarifës për vitin 2020, kemi gjenruar një projeksion

të mbledhjes së tarifave sipas tabelës më poshtë e cila vendos objektiva që për kategorinë familjare dhe biznes I vogël, rritja vjetore e % së mbledhjes së tarifës të jetë 10% në vit, për bizneset e mëdha me 5% në vit ndërsa për institucionet me 30% në vit.

	2020	2021	2022	2023	2024	2025
familjare	14,206,000	15,626,600	17,189,260	18,908,186	20,799,005	22,878,905
biznes I vogël	14,055,000	15,460,500	17,006,550	18,707,205	20,577,926	22,635,718
biznes I vogël	24,987,000	26,236,350	27,548,168	28,925,576	30,371,855	31,890,447
institucione	273,000	354,900	461,370	599,781	779,715	1,013,630

Tabela e mësipërme për mbledhjen e tarifës do të sillte progresivisht edhe rritjen e mbulimit të koston të shërbimit vit pas viti, sipas grafikut më poshtë.



Kjo politikë e shpërndarjes së barrës për mbulimin e kostove të shërbimit bazohet në praktikat më të mira brenda dhe jashtë vendit. Sipas tyre, ndotësi paguan, që do të thotë se barra shpërndahet ndërmjet grupeve të subjekteve sipas masës në të cilën ata gjenerojnë mbetje. Rrjedhimisht pjesa më e madhe e koston do të mbulohe nga familjet, dhe pjesa më e vogël nga institucionet.

Më tej, me qëllim mbledhjen e plotë të koston të shërbimit, barra e koston për t'u shpërndarë tek subjektet pagues, ose niveli i faturimit, është në çdo vit i korigjuar me përqindjen e planifikuar të realizimit të të ardhurave, e cila fillon me 73% në vitin e parë dhe arrin në rreth 85% të të ardhurave që mbledhen në vitin 2025. Këto objektiva janë vendosur nisur nga norma aktuale e realizimit të të ardhurave nga shërbimi, e cila është në nivelin rreth 70%. Në këtë mënyrë barra e koston është vazhdimisht më e lartë se kosto e shërbimit, por njëkohësisht ajo edhe zvogëlohet vazhdimisht. Për rrjedhojë, tarifat e subjekteve pagues janë në zbritje gjatë periudhës 2021-2025. Mbi bazën e politikave si më sipër, në tabelën në vijim parashtrihen tarifat e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve për bizneset e mëdha dhe të vogla në vitet 2021-2025. Kjo tarifë është

marrë në vlerë mesatare pasi tarifat janë të diferencuara sipas llojit të biznesit nga 17,000 Lek në 250,000 Lek për biznesin e madh dhe nga 1,000 Lek në 30,000 Lek për biznesin e vogël⁷.

Tarifa mesatare e planifikuar	2021	2022	2023	2024	2025
Biznesi i madh Lek/vit	138,500	133,068	128,421	124,421	120,965
Biznesi i vogel Lek/vit	15,500	14,892	14,372	13,924	13,538

Table 9 Parashikimi i tarifave vjetore me ulje per biznesin në vitet '21-'25

Sistemi i tarifimit lejon diferencimin e barrës edhe brenda për brenda grupeve të subjekteve, veçanërisht për bizneset dhe familjet.

Këtu, tarifa e bizneseve paraqitet e pa diferencuar për madhësinë e biznesit: i madh, i mesëm dhe i vogël, dhe gjithashtu e pa diferencuar në lidhje me llojin e biznesit: prodhues, tregtues, shërbimi apo kategori të tjera. Këto diferencime janë pjesë e politikave të bashkisë të cilat mund të vendosen në mirëkuptim me komunitetin e biznesit në territorin e saj.

Në grafikun e mëposhtëm, paraqitet prirja rënëse e tarifës vjetore të shërbimit për familjet, gjatë periudhës kohore 2021-2025. Në këtë grafik tarifa paraqitet e ndarë vetëm për shërbimin e pastrimit, jo për të gjitha shërbimet bashkë. Duhet theksuar se tarifa për familjet mbulon rreth gjysmën e vlerës së përlogaritur të kostos për familje, por kjo barrë ndahet për bizneset dhe nga fondet e vetë bashkisë.




Figure 8 Parashikimi i tarifave vjetore me ulje per familjet në vitet '21-'25

⁷ Të dhënat për parashikimin e të ardhurave janë marrë nga paketa fiskale e bashkisë Lezhë për vitin 2021

Është pjesë e politikave të Bashkisë Lezhë lehtësimi i barrës së tarifës së shërbimit për grupe të caktuara të subjekteve familjare ashtu si dhe për biznese të caktuara. Këto politika mund të ndërmerren si masa sociale ose si masa nxitëse për mbrojtjen e mjedisit.

- A. Kështu, për grupet e familjeve në nevojë të kategorive të ndryshme është e mundur caktimi i tarifës së shërbimit me vlerë të reduktuar ose përjashtimin nga detyrimi për të paguar tarifën; caktimi i një tarife të reduktuar është e mundshme dhe për zonat rurale të bashkisë, si për shembull në njësi administrative më të thella.
- B. Për biznese të cilat angazhohen në veprimtari ricikluese ose ndërgjegjësuere të banorëve për mbrojtjen e mjedisit mund të caktohet një tarifë me vlerë të reduktuar.

14.3 Bilanci financiar

Sistemi tarifor i parashtruar më sipër ka për objektiv mbulimin e kostos së shërbimit në masën 90% me të ardhurat nga tarifa. Në tabelën që vijon janë paraqitur vlerat e të ardhurave të planifikuara për t'u realizuar nga tarifat e përlllogaritura dhe sipas numrit të familjeve, bizneseve dhe institucioneve të vendosur në bashkinë Lezhë. Në fund të çdo viti, në një situatë ideale, buxheti financiar i shërbimit duhet të rezultojë i balancuar, tërësisht me burime vendore të të ardhurave. Më poshtë po japim një tabelë që supozon maksimalizimin e të ardhurave nga secila kategori që merr shërbim në mnyër që ky shërbim të mbulohet maksimalisht nga të ardhurat e veta.

	2020	2021	2022	2023	2024	2025
familjare	21,432,000	23,575,200	25,932,720	28,525,992	29,952,292	32,348,475
biznes I vogël	16,387,000	18,025,700	19,828,270	21,811,097	22,901,652	25,191,817
biznes I madh	26,737,000	28,073,850	29,477,543	30,951,420	31,570,448	32,201,857
institucione	2,603,000	3,383,900	4,399,070	5,278,884	5,331,673	5,331,673
Totale	67,159,000	73,058,650	79,637,603	86,567,393	89,756,064	95,073,822
shpenzimet		78,703,575	82,638,754	86,770,691	91,109,226	95,664,687
mbulimi I shpenzimeve		92.83%	96.37%	99.77%	98.51%	99.38%

14.3.1 Shpenzime mbështetëse

Përkrah kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, një fond shtesë është i nevojshëm të parashikohet për disa shpenzime mbështetëse të cilat kanë për qëllim përmbushjen e objektivave të të qëndrueshmërisë financiare. Këto shpenzime mbështesin veprimtaritë bashkiake të mëposhtme:

1. Ndërgjegjësim dhe edukimi i banorëve për mbrojtjen e mjedisit

Kjo veprimtari planifikohet të mbështesë rritjen e efektivitetit të mbledhjes së të ardhurave të shërbimit nga subjektet pagues, në masën e përmbushjes së objektivave të vendosur në këtë drejtim, të paraqitur si më sipër. Plani i veprimit parashikon shpenzime vjetore shtesë gjatë gjithë periudhës 2021-2025, të cilat mund të shtrihen dhe në periudha të mëvonshme, në varësi të objektivave të mëtejshme të Bashkisë Lezhë. Duhet patur parasysh se edhe në përlllogaritjen e kostos së shërbimit është llogaritur një 2% e vlerës si shpenzime për ndërgjegjësim.

2. Ngritja e bazës së të dhënave të subjekteve pagues

Një bazë të dhënash mbi subjektet gjeneruese të mbetjeve, në formatin e një programi kompjuterik, është një instrument i domosdoshëm për vënien në jetë të sistemit të tarifimit të shërbimit të menaxhimit të tyre dhe rritjes së efektivitetit të mbledhjes së të ardhurave nga tarifa. Një identifikim i saktë i këtyre subjekteve: vendndodhjes së tyre, madhësisë e gjendjes financiare të tyre, llojit të aktivitetit në rast biznesi etj., i mundëson autoriteteve vendore ndjekjen e rasteve të subjekteve që nuk paguajnë dhe zbatimin efektiv të masave shtrënguese. Edhe në këtë rast, përveçse krijimit të një asemi vendor me vlerë afatgjatë, baza e të dhënave duhet t'i shërbejë drejtpërdrejt përmbushjes së objektivave të vendosur për rritjen e % së mbledhjes së të ardhurave të shërbimit, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë financiare. Baza e të dhënave do të përditësohet çdo vit dhe mund të përdoret për tarifimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve si dhe të shërbimeve të tjera publike, në rast të përshtatshëm. Shpenzimet për këtë veprimtari kryhen vetëm në vitin e parë të planit dhe vlera e tyre parashikon kontraktimin e një konsulenti që do të hartojë dhe ndërtojë bazën e të dhënave.

3. Faturimi i tarifës së shërbimit

Bashkia Lezhë ka arritur që nëpërmjet faturimit me anë të faturës së Ujësjetllës Kanalizime Lezhë, të gjenerojë faturën për shumicën e klientëve të saj. Duke qenë se një pjesë e madhe e popullsisë së bashkisë do të mbulohet nga ky shërbim, faturimi me faturën e UKL do të vazhdojë. Mbetet sfida faturimi i tarifës së shërbimit për banorët që nuk faturohen nga UKL, i cili është një proces operativ i cili planifikohet të kërkojë një fond vjetor të vazhdueshëm në kohë, përtej periudhës kohore të këtij plani.

FIRMA

- | | |
|----------------------|---|
| - Ermal Pacaj, | Zv/ Kryetar i Bashkisë |
| - Elson Frroku, | Drejtor, Drejtoria e Integritimit Evropian |
| - Brikena Vuksani, | Drejtor, Drejtoria e Finances dhe Buxhetit |
| - Arjan Barbullushi, | Drejtor, Drejtoria e të Ardhurave dhe Tarifave Publike |
| - Elton Zefi, | Drejtor, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrast. dhe Mjedisit |
| - Gentian Malotaj, | Drejtor, Drejtoria Juridike |
| - Flora Dedgjonaj, | P/ Sektori, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrast. dhe Mjedisit |
| - Sidrit Çuni, | Supervizor, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrast. dhe Mjedisit |
| - Indrit Torbaj, | Specialist, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrast. dhe Mjedisit |
| - Zef Zefi, | Ing. IT, Drejtoria e Integritimit Evropian |
| - Naim Cara, | Ing. Ndertimi, Drejtoria e Planifikimit të Terri. dhe Zhvill. Urban |